

INSTITUCIONET E REJA TË DREJTËSISË: BILANCI DHE SFIDA

Monitorimi i aktivitetit të KLGJ, KLP, KED, KKRD

SHTATOR 2019 – MARS 2020

ISP
INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE

RAPORTI ËSHTË REALIZUAR NGA STAFI I ISP NË KUADËR TË PROJEKTIT
"SISTEMI I RI I DREJTËSISË: TRANSPARENCË DHE PËRFSHIRJE. MONITORIMI I KLGJ, KLP, KED, KKRD DHE LIGJËRIMIT PUBLIK"
MBËSHTETUR NGA PROGRAMI I REFORMËS NË DREJTËSI,
FONDACIONI SHOQËRIA E HAPUR PËR SHQIPËRINË.

Mendimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe të ISP.
Ato nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e donatorit.

FONDACIONI SHOQËRIA E HAPUR PËR SHQIPËRINË

Ekipi realizues i monitorimit

Prof. Ervin Karamuço, lektor i së drejtës, UT
Dr. Armela Kromiçi, lektor i së drejtës, UT
Prof. As. Dr. Anjeza Liçenji, lektor i së drejtës, UT

INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE
Web: wwwisp.com.al
Email: contactaips@isp.com.al dhe contactaips@gmail.com
Facebook: Instituti i Studimeve Politike / Institute for Political Studies
Adresa: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë

HYRJE

Instituti i Studimeve Politike (ISP) ka vijuar edhe gjatë vitit 2019 dhe 2020 të bëjë monitorimin e institucioneve kryesore të sistemit të drejtësisë, KLGJ, KLP, KED dhe KMRD. Monitorimi është kryer në kuadrin e projektit të ISP "Sistemi i ri i drejtësisë: transparencë dhe përfshirje. Monitorim aktiv i KLGJ, KLP, KED, KKRD" mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Programi i Reformës në Drejtësi.

Reforma në drejtësi njohu zhvillime të reja në fundin e vitit 2019 dhe në fillimin e vitit 2020, me zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, SPAK dhe drejtuesit të tij, të katër anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të tre anëtarëve të Gjykatës së Lartë. Më shumë se tre vite nga ndryshimet kushtetuese për reformën në drejtësi vendi ndodhet në fazën kur reforma ka nisur të japë rezultate konkrete dhe ku vëmendja kryesore kalon nga institucionet tek aktet konkrete të dhënies së drejtësisë. KLGJ dhe KLP luajtën një rol të rëndësishëm në këtë drejtim.

Lidhur me institucionin e KED sfida kryesore ishte realizimi i procesit të përzgjedhjes dhe renditjes së kandidatëve për në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Konflikti institucional dhe politik çoi në investimin përsëri të Komisionit të Venecias për të shprehur opinionet përkatëse në lidhje me procedurën dhe vendimmarrjen në zbatim të saj. Deri në mars 2020 ende nuk është bërë publik raporti final i opinionit të Komisionit të Venecias, raport i cili mund të ketë impakt në vendimmarrjet e ardhshme lidhur me vendet në Gjykatën Kushtetuese dhe për vetë aktivitetin e KED.

Raporti monitorues paraqet një pamje horizontale të problematikës dhe gjetjeve kryesore, të kryer nga ekspertë në emër të ISP kanë kryer monitorim aktiv të çdo mbledhjeje, akti, vendimmarrjeje, të këtyre strukturave. Në disa raste mund të ketë opinione të ndryshme midis vlerësimeve që institucionet kanë për veten e tyre dhe opinioneve të ekspertëve, por ISP e konsideron shkëmbimin e opinioneve si pjesë të rëndësishme të procesit të monitorimit dhe vlerë në rritjen e cilësisë dhe standardeve vendimmarrëse të institucioneve të reja të drejtësisë.

ISP ka kryer njëherësh edhe monitorimin dhe një raport mbi ligjërimin e reformës në drejtësi. Të dyja raportet do të jenë publike në faqen e internetit www.isp.com.al. Stafi i ISP i angazhuar në këtë projekt përbëhet nga ekspertë të studimeve juridike, pedagogë të Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës (për monitorimin e institucioneve të drejtësisë) dhe pedagogë të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës (për ligjërimin politik e publik). Konkretisht, raporti mbi monitorimin e KLP është hartuar nga Dr. Armela Kromiçi, raporti mbi monitorimin e KLGJ dhe KPRD është hartuar nga Prof. Ervin Karamuço, raporti mbi monitorimin e KED është hartuar nga Prof. As. Dr. Anjeza Liçenji, raporti mbi ligjërimin është drejtuar nga Dr. Lisien Roseni. Projekti është koordinuar nga Prof. Afrim Krasniqi.

METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Instituti i Studimeve Politike ka filluar monitorimin e veprimtarisë së KLGJ + KLP-së në 26 Mars 2019. Metodologjia e monitorimit të aktivitetit të KLGJ + KLP-së ka qenë e strukturuar në disa elementë, të cilët kanë gjetur në vijimësi vëmendjen e duhur për të dokumentuar në mënyrë të plotë punën e këtij institucioni:

- *elementë sasiorë (çështje të formës dhe procedurës)*
- *elementë cilësorë (çështje të përmbajtës në vendimmarrje).*

Në elementët sasiorë, janë mbajtur në konsideratë për tu monitoruar: numri i mbledhjeve në shtrirje kohore; volumi i shqyrtimit të çështjeve për mbledhje; procedura e kryerjes së njoftimit për çdo mbledhje; procedura e aksesit paraprak të dokumenteve për mbledhjen e ardhshme; rregullsia e pjesëmarrjes së anëtarëve në mbledhje dhe aktivizimi i tyre ; procedura e drejtimit të mbledhjeve dhe ekuilibrimi i kohës së diskutimeve për anëtarët; rregullsia e radhës së veprimeve për respektimin e rendit të ditës; rregullsia e zhvillimit të shqyrtimit të çështjeve, diskutimit dhe moderimi i replikave midis anëtarëve si dhe rregullsia dhe dokumentimi shkresor, audio dhe video i mbledhjeve.

Në elementët cilësorë, janë mbajtur në konsideratë për tu monitoruar:

- *përmbajtja e rendit të ditës dhe rëndësia e çështjeve në shqyrtim; planifikimi strategjik për drejtimin e veprimtarisë;*
- *puna për thjeshtimin e vendimmarrjes dhe volumit nëpërmjet elementëve de-burokratizues;*
- *aktivizimi cilësor i diskutimeve dhe relatimeve të anëtarëve;*
- *dokumentimi i plotë i çështjeve në shqyrtim; evidentimi dhe dokumentimi i qëndrimeve kundër dhe argumentimi i tyre; cilësia e burimeve informative dhe të aksesit ndaj publiku;*
- *cilësia, kompletimi dhe përputhshmëria ligjore e akteve të brendshme që normojnë veprimtarinë e tij; monitorimi i strukturës së stafit mbështetës);*
- *publikimi i plotë dhe në kohë i vendimeve, si dhe eficensa në evadimin e çështjeve të mbartura;*
- *mbështetja financiare dhe problematikat mbi infrastrukturën dhe logjistikën institucionale,*
- *si dhe mbledhjet e nën - komisioneve, funksionimi dhe vendimmarrjet e tyre.*

Stafi i ISP ka kontaktuar që në fillim të monitorimit me drejtuesit e institucioneve dhe ka marrë pjesë rregullisht në të gjitha mbledhjet e zhvilluara në KLGJ dhe KLP. Për institucionin e KED, stafi i ISP ka komunikuar duke shfrytëzuar të drejtën për informim si dhe të dhënat e publikuara në faqen e internetit nga ky institucion.

GJETJET KRYESORE DHE REKOMANDIME

- **KLGJ dhe KLP vijojnë të jenë edhe gjatë vitit 2019-2020 pika referimi dhe organet kryesore vendimmarrëse në jetësimin e reformës në drejtësi. Ato arritën që të plotësojnë detyrimin kushtetues për zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm, për zgjedhjen e SPAK, si dhe për zgjedhjen e anëtarëve të parë në Gjykatën e Lartë. Kjo është një bazë e mirë vendimmarrëse për të kaluar nga përpjekja e plotësimit minimal të institucioneve të larta të drejtësisë në synimin për mirëfunksionimin e tyre në kapacitete dhe vendimmarrje.**

- **Vijimi pa një Gjykatë Kushtetuese dhe Gjykatë të Lartë vendimmarrëse dhe për më shumë se 1.5 vjet ishte dhe mbetet një shqetësim serioz për standardet e drejtësisë dhe aksesin për drejtësi të qytetarëve. Aktualisht GJK ka 4 anëtarë dhe GJL 3 anëtarë, por institucionet përgjegjëse KLGJ dhe KED duhet t'í kushtojnë rëndësi primare marrjes së masave të menjëhershme për përmbushjen e detyrimeve ligjore përsa i takon plotësimit të vendeve vakante në këto institucione jetike të sistemit të drejtësisë.**

- **Procesi i vettingut dhe i zgjedhjes së institucioneve të reja është shoqëruar me vakanca në nivele të ndryshme të gjyqësorit dhe prokurorisë. KLGJ dhe KLP do të duhet të kenë një strategji, plan konkret dhe vizion të qartë për të minimizuar pasojat negative dhe për t'u paraprirë situatave të ngjashme, në mënyrë që sistemi të mbetet funksional dhe qytetarët të përfitojnë nga rezultatet e prekshme të reformës në drejtësi. Premtimi dhe pritshmëria e reformës ka qenë e mbetet ofrimi i drejtësisë së shpejtë, të pavarur dhe profesionale, si parakusht për suksesin e saj dhe rikthimin e besimit tek institucionet e drejtësisë.**

- **KLGJ duhet të miratojë sa më shpejt Hartën Gjyqësore, si dokument bazë referimi për emërimet, ndryshimet, ngarkesën e punës, vendimmarrjet dhe funksionimin sa më të drejtë e maksimal të sistemit gjyqësor. Në përputhje me të KLGJ e KLP do të duhet të ketë gjithashtu një qasje strategjike në përputhje me Planet Strategjike të miratuara ose në shqyrtim, për të identifikuar prioritetet, standardet, pritshmëritë dhe rezultate më të prekshme të reformës dhe vendimmarrjes së tyre.**

- **KLGJ do të duhet të përcaktojë qartësisht numrin e anëtarëve të Gjykatës së Lartë (neni 90, ligji 98/2016), si dhe KLP të marrë masa për plotësimin tërësor të strukturave të SPAK. KED do të duhet të jetë shumë me efikas në procesin e kandidatëve për në Gjykatën Kushtetuese.**

- **Këshilli i Monitorimit nga Kuvendi të Reformës në Drejtësi (KMRD), si edhe gjatë 2019 edhe më 2020 nuk arriti të krijojë një institucion referues dhe funksional, ndaj nevoja e një sjellje më aktive, më transparente dhe të orientuar drejt prioriteteve të misionit të tij mbetet sfida për periudhën në vijim.**

- **KLGJ dhe KLP, me aktivitetin e tyre e zhvendosën vëmendjen dhe interesin e opinionit publik dhe të medias, nga elementët administrativë të përbërjes dhe funksionimit të tyre, tek vendimmarrjet për jetësimin e institucioneve kryesore të sistemit dhe në rritjen e standardeve të organizimit gjyqësor dhe të prokurorisë së vend.**

- **KLP ka miratuar disa rregullore të rëndësishme, por nuk ka miratuar një rregullore të brendshme që është domosdoshmëri për zbatimin e parimeve të mirëqeverisjes. Po ashtu, Rregullorja *"Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë SPAK"* u miratua pas mbylljes së afatit për dorëzimin e kërkesave nga kandidatët e interesuar për të aplikuar në pozicionet vakante në SPAK, praktikë që duhet ndryshuar e përmirësuar në të ardhmen.**

- **Për të gjithë procesin e komandimeve dhe emërimeve të përkohshme secila strukturë, sidomos KLP, do të duhet të kenë një plan strategjik dhe Rregullore mbi promovimin, standardizim të vendimmarrjeve dhe shumë më tepër transparencë dhe informim publik.**

- **KED ka pasur një rol thelbësor gjatë periudhës maj 2019 – mars 2020 2019-mars 2020 në përzgjedhjen e kandidatëve për në Gjykatën Kushtetues edhe për Inspektor të Lartë të Drejtësisë. Praktika e ndjekur nga KED ndonëse është vlerësuar pozitivisht ka shkaktuar debate e kontestime të mëdha publike. Mosmarrëveshjet u adresuan në Komisionin e Venecias për opinion vlerësues dhe përfshinë edhe institucionin e Presidentit, Kuvendit etj, ndërkohë që një zhvillim kritik ishte pamundësimi prej tij i institucionit të Avokatit të Popullit për ndjekjen normale të mbledhjeve dhe vendimmarrjeve.**

- **KED pati probleme dhe mangësi të mëdha në transparencën e veprimtarisë së tij sidomos në lidhje me vonesat e pajustifikueshme të publikimit të procesverbaleve të debatit në mbledhje dhe në vendimmarrje. Për shkak se KED i zhvillon mbledhjet me dyer të mbyllura publikimi i procesverbaleve është detyrim ligjor, standard demokratik, por edhe ndihmon në mbushjen e boshllëkut që krijohet në publik.**

- **KED u ripërtëri gjatë muajit dhjetor 2019, përmes një procedure transparente, megjithatë kryetari mbeti i njëjtë edhe për shkak se Gjykata e Lartë ka vetëm një anëtar, të cilit i ka**

mbaruar mandati 9 vjeçar që në vitin 2014. Mungesa e konkurrencës për të qenë anëtar apo kryetar i KED, sipas përcaktimeve ligjore, e dobësoi edhe raportin e besimit publik tek KED dhe ndikoi në rritjen e kritikave ndaj tij.

- **Komisioni i Venecias është ende në shqyrtimin e praktikës që lidhet me emërimet e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, ndërsa Presidenti i Republikës ka iniciuar kallëzim penal ndaj kryetarit të KED[1]. Filtri i përdorur nga KED për përzgjedhjen e kandidaturave ka qenë tepër i imët, duke evituar në këtë mënyrë gjetjet që mund të verifikohen pas emërimit, të cilat do të çonin në tërheqjen e kandidatëve dhe në lënien e vendit bosh nga ana e tyre. Ky verifikim mundëson plotësimin e vakancave në mënyrë përfundimtare dhe krijimin e organeve të qëndrueshme të drejtësisë.**

- **Afati kohor prej 15 ditësh, për plotësimin e formularëve për deklarimin e pasurive, është konsideruar i pamjaftueshëm prej kandidatëve pasi ata kanë qenë në pamundësi objektive nisur nga numri i madh i institucioneve në të cilat duhet të tërhiqnin dokumentacionin përkatës brenda dhe jashtë vendit. Kjo ka sjellë tërheqjen e tyre. Prandaj, është e domosdoshme që të ketë një bashkëveprim ndërmjet institucioneve për të mundësuar aplikimin dhe shtimin e numrit të kandidatëve, të cilët janë pakësuar ndjeshëm si rezultat i tërheqjes për shkak të pamundësisë në dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm.**

- **Përjashtimi i Avokatin e Popullit si dhe përfaqësuesit e subjekteve të cilët ftohen sipas ligjit në bisedimet e çështjes, si edhe gjatë votimit të sjellë një kufizim të paligjshëm të kompetencave të Avokatit të Popullit, pasi i mohohet e drejta për të marrë dijeni dhe për të mbrojtur interesat e palëve. Gjithashtu, ky fakt ngre pikëpyetje edhe përsa i përket transparencës dhe marrjes përsipër të përgjegjësisisë në marrjen e vendimeve. Vetë instituticioni i Avokatit të Popullit ka ngritur nje padi kunder KED në Gjykatën Administrative të Apelit për shkelje të kompetencave të këtij institucioni.**

- **Numri i kandidatëve të cilët plotësonin kushtet ligjore për tu zgjedhur anëtarë të Gjykatës Kushtetuese ose kandidatët për ILD ka qenë tepër i ulët, madje në vakancat e Gjykatës Kushtetuese paraqiten të njëjtët emra për vakanca të ndryshme.**

- **Është e rekomandueshme që kandidaturat që do të përfshihen në listat e KED të kenë përfunduar fillimisht procesin e vettingut, pasi kjo do të shmangte vënien në lëvizje të**

[1] Deri nw shkrimin e këtij raporti (prill-maj 2020) ende nuk kishte vendim nga KLGJ mbi kryetarin e KED dhe ende nuk wshtw bwrw publik opinioni zyrtar i Komisionit tw Venecias.

institucioneve të emërtesës si dhe cënimin e besimit të publikut në një rast shkarkimi të mëvonshëm të kësaj kandidature nga organet e vettingut.

- **Kriteret e vendosura nga ligji janë të forta dhe burimet njerëzore të interesuara për GJK janë të pamjaftueshme për të garantuar një konkurrueshmëri të lartë midis kandidaturave.**

- **KLGJ dhe KLP treguan vëmendje ndaj rasteve të cenimit të jetës ose të drejtave të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke i marrë ata nën mbrojtje, si dhe u treguan refraktarë dhe nxitën hetime në rastet kur gjyqtarë apo prokurorë u bënë pjesë të akuzave, skandaleve apo incidenteve të rënda që cenojnë figurën e tyre. Krijimi i ILD përbën një zhvillim pozitiv dhe një mundësi që çdo ankesë dhe rast të kalojë për trajtim ligjor dhe disiplinor, sipas ligjit.**

- **KLGJ dhe KLP rekomandohet të krijojnë në harmoni dhe me standarde të njëjta, rregullore të brendshme funksionale dhe kodet e etikës. Pas fazës së parë të jetësimit dhe vendimmarrjeve të para të tyre, tashmë nevoja për më shumë transparencë në debatet e brendshme, në parandalimin e konfliktit të interesit dhe në apelimin e standardeve më të larta etike në punën e tyre dhe në marrëdhëniet publike janë nevojë dhe kërkesa të kohës.**

- **KLGJ dhe KLP kanë dëshmuar standarde profesionale në organizimin e mbledhjeve të tyre, drejtimin dhe menaxhimin e debatit, në aplikimin e elementëve të solemnitetit dhe evitimin e gjuhës jo etike, si dhe në ndarjen e rendit të ditës me grupet monitoruese të shoqërisë civile.**

- **KLGJ dhe KLP kanë raportuar rregullisht në parlament dhe në strukturat e integrimit, duke përmbushur detyrimin e tyre ligjor, por edhe duke ndikuar pozitivisht në prezantimin e problematikave dhe bilancit të tyre të punës. Në aspektin ndërinstitucional KLGJ dhe KLP kanë qenë shumë më korrekt në bashkëpunim me parlamentin dhe qeverinë sesa këto të fundit. Mbështetje logjistike ende nuk është e plotë, struktura organike e KLGJ dhe KLP ende nuk është plotësuar, elementët e sigurisë ende nuk janë garantuar dhe një numër kërkesash e ankesash të tyre të parashtruar në parlament ende nuk kanë marrë zgjidhje.**

- **KLGJ dhe KLP kanë pasur bashkëpunim intensiv me partnerët kryesorë ndërkombëtarë të Shqipërisë, gjë që i ka ndihmuar të forcojnë elementët e pavarësisë së tyre në raport me aktorët politikë në vend. Megjithatë, fokusimi kryesisht vetëm tek partnerët ndërkombëtarë mund të mos jetë efektiv në të ardhmen, ndërkohë që fokusimi më i**

madh në bashkëpunimin e brendshëm institucional dhe në transparencën publike me qytetarët do të mund të kishte ndikim më afatgjatë në qëndrueshmërinë e punës së tyre dhe në bilancin e reformës në drejtësi.

- **KLGJ dhe KLP shfaqën gjatë periudhës së monitorimit shumë më tepër elementë të transparencës sesa KLD e mëparshme. Mbledhjet më të rëndësishme u bënë publike, media raportoi lirisht për çdo vendimmarrje dhe aksesi për informacion nuk pati kufizime. Problematika mbetet respektimi i plotë i detyrimeve që burojnë nga programi i transparencës në ligjin 118/2014 për të drejtën e informimit, pasi faqet online të dy institucioneve ende nuk janë burim i plotë informimi dhe referimi.**

- **KLGJ ka arritur të miratojë mbi 449 vendime në 14-15 muaj, çka përbën një volum të madh pune, megjithatë rreth 16-18% e rasteve kanë qenë vendime për transferime të përkohshme të gjyqtarëve. Sfidë e KLGJ-së vijon të mbetet riorganizimi i organeve gjyqësorë në varësi të numrit të çështjeve dhe gjyqtarëve përkatës, për të reduktuar volumin e madh të vendimmarrjeve nga ana e tij, për lëvizjet e përkohshme të gjyqtarëve nga njëra gjykatë në tjetrën.**

- **KLGJ dhe KLP duhet të reduktojnë në maksimum praktikat e shumta të deritanishme të caktimit të përkohshëm të prokurorëve apo gjyqtarëve, si dhe të orientohen në emërime përfundimtare të tyre, si parakusht për rritjen e cilësisë, besimit dhe profesionalizmit të vendimmarrjes në sistemin e drejtësisë.**

- **KLGJ dhe KLP do të duhet të marrin masa për plotësimin 100% të stafit mbështetës, në kualifikimin e tyre dhe në zgjerimin e kapaciteteve të brendshme të përpunimit të të dhënave, mbi të cilat mund të ndërtohen strategji që ofrojnë zgjidhje në të ardhmen. Synimi i tyre duhet të jetë trajtimi i çështjeve përpara se të shfaqen si pengesa, jo thjesht menaxhimi i pengesave që vazhdimisht shfaqen në gjyqësor apo prokurori.**

- **Komisionet e brendshme të punës në KLGJ dhe KLP, sipas ligjit, duhet të bëjnë raportime vjetore (çdo muaj janar), gjë që meriton të jetë në vëmendje, për të siguruar funksionalitet maksimal të tyre, por edhe për të rritur transparencën mbi aktivitetin dhe këto vendimmarrje.**

- **KLGJ duhet të fokusohet shumë më tepër në sfidën e saj për plotësimin e vendeve në Gjykatën e Lartë, si dhe në marrjen e masave për respektimin e afateve ligjore pavarësisht vështirësive e mungesave në personelin gjyqësor.**

- **KLGJ dhe KLP duhet të publikojnë rregullisht mendimet kundër të anëtarëve dhe të krijojnë akses për median dhe grupet civile, për rastet e ankesave ndaj vetë anëtarëve të tyre.**

- **KLGJ ende nuk ka miratuar hartën gjyqësore në vend, pavarësisht se është një prej detyrimeve ligjore të tij, ndërsa duhet të bëjë më shumë për hartimin e një plani për mbarëvajtjen e veprimtarisë së KLGJ-së në drejtim të planifikimit dhe organizimit më të efektshëm të pushtetit gjyqësor në përballimin e shërbimeve publike të kërkuara dhe të impaktit nga procesi i vettingut;**

- **KLP ka zhvilluar rreth 50 mbledhje në 14-15 muaj, një volum i madh pune, por që tashmë më shumë sesa sasi mbledhjesh kërkon rritje të standardeve cilësore të tyre. Ai duhet të përshpejtojë punën për plotësimin e vendeve vakante në vetë përbërjen e tij.**

- **KLP u përball me problematikën e ndërprerjes së mandatit për së paku dy anëtarë të tij të deritanishëm, një problematikë që krijon debat mbi legjitimitetin dhe integritetin e vendimmarrjes së deritanishme të anëtarëve që rezultojnë të papërshtatshëm nga organet e rivlerësimit, KPK dhe KPA.**

- **KLGJ dhe KLP duhet të planifikojnë në mënyrë efikase burimet e tyre financiare dhe njerëzore, me qëllim përmbushjen e pritshmërive, duke miratuar një planifikim strategjik afatmesëm të aktivitetit të tyre duke identifikuar përparësitë, sfidat dhe risqet e mundshme.**

- **KLP ka aplikuar disa herë shtyrjen e afateve të shpallura ligjore që lidhen me kandidime ose procese zgjedhore, siç ishte rasti i përbërjes së SPAK dhe më pas i drejtimit të tij, por në të ardhmen sugjerohet vendosja e afateve të arsyeshme ligjore dhe respektimi maksimal i tyre.**

- **Praktikat e vendimmarrjeve, si p.sh, të KLP, për pagesat e prokurorëve për punën e kryer jashtë orarit zyrtar apo për veprimtaritë jashtë funksionit të Prokurorëve janë modele pozitive referuese.**

- **Përgatitja e programit të transparencës për KED, në përputhje të plotë me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës KED ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI-së. Veprimtaria e KED është lehtësisht e kuptueshme dhe e aksesueshme nga të gjithë,pa qenë nevoja e kërkesave për marrje dijeni.**

- **Për një funksionim sa më të mirë të KED të 2020, duke u bazuar edhe tek eksperienca e KED paraardhëse, shtimi i kapaciteteve njerëzore të angazhuar pranë këtij këshilli do të mundësonte një përmbushje sa më të plotë të të gjitha detyrimeve dhe parashikimeve ligjore, si për sa i përket publikimit të materiale të mbledhjeve, të procesverbaleve, akteve normative, etj, si dhe plotësimi i të gjitha vakancave në Gjykatën Kushtetuese, duke përmbushur në këtë mënyrë vetë funksionin dhe qëllimin për të cilin është parashikuar dhe krijuar ky Këshill.**

- **Një fakt i konstatuar në lidhje me transparencën në marrjen e vendimeve dhe paanshmërinë e Këshillit është edhe rasti i miratimit të metodologjisë së vlerësimit. KED ka shpallur thirrjet për kandidatët për ILD, dhe pas paraqitjes së kandidaturave, miratohen kriteret e vlerësimit të kandidaturave, kur në fakt më transparente do të ishte nëse kjo metodologji vlerësimi do të ishte miratuar para shpalljes së thirrjes për vendin vakant. Miratimi i metodologjisë së vlerësimit, pasi merret dijeni për kandidatët që kanë aplikuar, kriteret që ata plotësojnë dhe eksperiencat që ata kanë mund të ngrejë dyshime se këto kritere vlerësimi dhe kjo metodologji mund të jetë miratuar duke favorizuar një ose disa persona të preferuar nga anëtarët.**

MONITORIMI I KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Ligji Nr. 115/2016 "Për Organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", krijoi Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGJ), si një organ kolegjial vendimmarrës, i cila ka si kompetencë kryesore zbatimin e parimit të vetëqeverisjes së pushtetit gjyqësor. Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas krijimit trashëgoi një sërë dosjesh dhe ankesash nga organi i mëparshëm i qeverisjes së gjyqësorit Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Praktikat e mëparshme, krijuan një mbingarkesë që në fillim në punën e KLGJ-së dhe për më tepër një konfuzion mbi mënyrën sesi do t'u jepej zgjidhje disa çështjeve, në kuadër të legjislacionit të ri mbi organet e drejtësisë[2]. Gjithsesi, edhe pse me këto vështirësi, Këshilli i Lartë Gjyqësor filloi aktivitetin e tij, duke u konstituar në 20 Dhjetor 2018, pra me një vonesë prej pothuajse 20 muajsh nga afati ligjor[3].

Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi mbledhjen e tij të parë konstituive më datë 20.12.2018, në të cilën, nën drejtimin e anëtarit më të vjetër jo gjyqtar Znj. Fatmira Luli, fillimisht u diskutuan dhe më pas u miratuan rregullat për zhvillimin e zgjedhjeve të Kryetarit dhe Zv. Kryetarit të KLGJ-së. Pas votimit që u zhvillua, rezultuan fitues në funksionin e Kryetares Znj. Naureda Llagami dhe në funksionin e Zv. Kryetarit Z. Maksim Çoku[4]. Në këtë rast rast vihet re se në drejtimin institucional të KLGJ-së të dy drejtuesit kryesor vijnë nga radhët e juristëve nga jashtë sistemit gjyqësor.

Në mbledhjen e datës 20 Dhjetor 2018, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka organizuar më tej hedhjen e shortit për caktimin e anëtarëve të KLGJ-së që do të shërbenin për një mandat 3-vjeçar në këtë organ. Në përfundim të hedhjes së shortit, rezultoi se nga anëtarët jo gjyqtar që do të vijojnë me mandate 3 vjeçar janë Z. Maks Çoku dhe Z. Erjon Muharremaj, ndërsa nga anëtarët gjyqtar Z. Mehdi Bici, Ilir Toska dhe Brunilda Kadi.

Që prej fillimit të zhvillimeve normale të mbledhjeve të tij, në periudhën Dhjetor 2018 dhe deri Shkurt 2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka zhvilluar 70 seanca të rregullta plenare, të cilat janë shpërndarë në shtrirje mujore si më poshtë.

Ajo që bie në sy në numrin e këtyre mbledhjeve, është shpërndarja e tyre jo e barabarte në shtrirje mujore. KLGJ që në fillim të aktivitetit të tij, ka paracaktuar vullnetarisht me praktikë pune një ritëm mesatar prej 4 mbledhjesh në muaj, por për shkak të volumit në komisione, mbingarkesës dhe fluksit të pa llogaritur në balancim kohor dhe në disa raste të paparashikuar, kjo shpërndarje nuk ja ka arritur të krijojë një normalitet të ekuilibruar.

---

[2] Trajtimi i ankesave të mëparshme ndaj pushtetit gjyqësor të depozituara në KLD, ku sipas ligjeve të reja këto ankesa i përkasin për trajtim Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

[3] KLGJ duhet të ishte konstituar jo më vonë se 8 muaj pas ndryshimeve kushtetuese të Korrikut 2016.

[4] Vendimi Nr.1 date 20.12.2018 "Mbi miratimin e rregullave për zgjedhjen e kryetarit dhe të zëvendëskryetarit të këshillit të lartë gjyqësor".

Nëpërmjet 70 seancave plenare të zhvilluara, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka arritur të miratojë gjithsej 449 vendime, çka përbën një volum të madh. Me krijimin e faqes se re online të KLGJ evidentohet fakti se figurojnë të publikuara të gjitha vendimet të ndara në rubrika si, udhëzime, akte normative, vendime individuale dhe vendime kolegjiale.



Lidhur me njoftimin për zhvillimin e mbledhjeve të KLGJ-së, është vënë re se njoftimet për institucionet e akredituara kryhen me e-mail tek personi kontaktit i paracaktuar. Problematikë e njoftimeve është afati i shkurtër midis dërgimit të njoftimit dhe zhvillimit të mbledhjes, ku ka patur raste kur mbledhjet apo shtyrja e tyre është lajmëruar brenda ditës. Gjithashtu në *e-mailet* e njoftimit, megjithëse bashkëlidhet gjithmonë rendi i ditës, nuk janë dërguar bashkëngjitur në mënyrë të përmbledhur projekt-vendimet që do të miratohen, duke krijuar një pështjellim në veprimtarinë e monitoruesve për të qenë të parapërgatitur mbi brendinë e dokumenteve për shqyrtim dhe diskutimet përkatëse që do të zhvillohen rreth tyre.

Që prej fillimit të organizimit të mbledhjeve të rregullta në Dhjetor 2018, në Këshillin e Lartë gjyqësor vihet re një prezencë dhe pjesëmarrje aktive e kënaqshme nga ana e drejtuesve dhe anëtarëve të tij. Prezenca dhe aktivizimi i tyre në mbledhje, solemniteti dhe serioziteti në diskutime, kanë qenë disa nga pikat e forta të konsolidimit të standardeve institucionale të KLGJ-së. Nga niveli i diskutimeve dhe analizave, si dhe nga dijenia e hollësishme e problematikave për çdo praktikë në shqyrtim, është vënë re se anëtarët e KLGJ-së përgatiten rregullisht për çdo mbledhje, duke siguruar një aktivizim cilësor.

1. Lidhur me aktivizimin e anëtarëve në debate, diskutime dhe analiza gjatë zhvillimit të mbledhjeve, vihet re në mënyrë të shpeshtë një dakordësi paraprake për shumicën e vendimmarrjeve, gjë e cila ka prodhuar një volum të reduktuar dhe moderuar të diskutimeve dhe debateve nga ana e tyre. Kjo tregon se projekt-vendimet e hartuara nga komisionet përkatëse të KLGJ-së, gjejnë një konsensus të qenësishëm, i cili më pas kalon formalisht me një prezantim të relatorit në mbledhje dhe me vërejtje të pakta. Ky është njëri nga shkaqet, që në përgjithësi mbledhjet e KLGJ-së përfundojnë brenda një kohe relativisht të shkurtër. Nga ana tjetër kjo procedurë që ndiqet, ka prodhuar një shpejtësi në evadimin e mjaft çështjeve të mbartura në koordinim me strukturat e tjera të institucionit, duke thjeshtuar trajtimin në kohë të praktikave dhe deburokratizimin e mjaft elementëve që shkaktojnë zvarritje të pajustifikuara.

   Mbledhjet e KLGJ-së të drejtuara nga Kryetari dhe në disa raste nga Nënkryetari janë zhvilluar gjatë gjithë kësaj periudhe në një klimë serioziteti dhe solemniteti të vazhdueshëm, duke ndjekur me përpikëri rendin e ditës së paracaktuar dhe publikuar. Nga monitorimi i kryer, janë nuk janë konstatuar raste që rendi i ditës të mos ezaurohet dhe të vendoset për mbartje në mbledhjen e radhës.

   Moderimi i drejtuesve të mbledhjes ka qenë i fokusuar krahas të tjerash edhe në drejtim të nxitjes së debatit, kërkesës për dhënien e mendimeve dhe sugjerimeve nga ana e anëtarëve të pranishëm, si dhe të arritjes së konsensusit për shumë prej çështjeve, ku parashtrohen fillimisht bindje dhe qëndrime të ndryshme. Në fund të disa mbledhjeve janë konstatuar qëndrime kundër të anëtarëve të KLGJ-së për vendimet e miratuara, të cilat nuk janë publikuar si mendime të veçanta me shkrim për njohje nga publiku.

   Mbledhjet e KLGJ-së kanë ndjekur një radhë procedurale të rregullt, duke respektuar fillimisht oraret e paracaktuara për zhvillimin e tyre, deklarimin formal të çeljes dhe mbylljes së mbledhjeve dhe konfirmimin e kuorumit të nevojshëm nga anëtarët. Kohëzgjatja e prezantimeve nga ana e relatorëve të çështjeve dhe diskutimeve nga ana e anëtarëve të tjerë të pranishëm, kanë qenë të ekuilibruara në kohë dhe nuk janë konstatuar raste ku të jenë ngritur pretendime për reduktim abuziv të hapësirave kohore në dispozicion. Në disa raste janë vërejtur replika midis anëtarëve, madje edhe me drejtuesin e mbledhjes, por këto nuk kanë cenuar etikën e komunikimit dhe mbarëvajtjen e mbledhjeve të KLGJ-së.

   KLGJ nuk ka miratuar ende një Rregullore të Përgjithshme të Brendshme mbi veprimtarinë e tij, si dhe në veçanti Kodin e Etikës të institucionit, dokument i cili do të rregullojë aspektet etiko-morale të sjelljes dhe performancës së administratës së KLGJ-së. Ky institucion ka miratuar rregullore të veçanta për çështje të lidhura me konfliktin e interesit dhe organizimin e

komisioneve të veçanta të tij, por ende një akt të veçantë në marrëdhëniet me publikun. Miratimi i këtyre dokumenteve mbetet një nevojë e ngutshme për tu realizuar.

Në mbledhjet e KLGJ-së, krahas anëtarëve, marrin pjesë rregullisht pjesëtar përfaqësues nga disa nivele teknike administrative, pjesë të komisioneve, drejtorive dhe sektorëve të këtij institucioni, të cilët sigurojnë mbështetje dhe ekspertizë juridiko-administrative gjatë takimeve dhe realizojnë dokumentimin e plotë të tyre. Mbledhjet e komisioneve të veçanta të KLGJ zhvillohen pa praninë e monitoruesve dhe nuk janë konstatuar raste që projekt-aktet e tyre, të jenë publikuar apo prezantuar paraprakisht për mendime apo konsultime.

Në ndihmë të një dokumentimi sa më të plotë të zhvillimit të mbledhjeve, mbahet një proces-verbal *(me stenografi)*, i cili hartohet dhe firmoset nga të gjithë anëtarët në mbledhjen pasardhëse me vendime të veçanta të KLGJ-së. Në mbështetje të procesit të dokumentimit të mbledhjeve, KLGJ ka në dispozicion dhe shfrytëzon nëpërmjet sallës së ish KLD-së aparatura teknike për garantimin e regjistrimit të rregullt audio dhe video të çdo mbledhje që zhvillohet. Regjistrimet audio te mbledhjeve janë publikuar së fundi në mënyrë të plotë në faqen zyrtare të KLGJ.

Nga këqyrja e plotë e përmbajtjeve të rendit të ditës së mbledhjeve të KLGJ-së dhe rëndësisë së çështjeve në shqyrtim nga ana e saj, konstatohet se ky institucion vijon të mbart mbingarkesë të aktivitetit rutinë "post KLD", duke u përpjekur të rimarrë kohën për evadimin e një sërë çështjesh të prapambetura.

Numri më i madh i çështjeve të trajtuara nga ana e saj, në masën 16 %[5] të gjithë totalit të vendimeve, mbetet ende vendimmarrja për transferimet e përkohshme të gjyqtarëve në gjykata të tjera për të evaduar çështje gjyqësore konkrete. Për pasojë, sfidë e KLGJ-së vijon të mbetet riorganizimi i organeve gjyqësorë në varësi të numrit të çështjeve dhe gjyqtarëve përkatës, për të reduktuar volumin e madh të vendimmarrjeve nga ana e tij, për lëvizjet e përkohshme të gjyqtarëve nga njëra gjykatë në tjetrën.

2. Një tjetër çështje e nxehtë në KLGJ, mbetet krijimi i një plani për ti paraprirë efekteve negative të krijimit të një vakumi të shpejtë dhe të paparashikuar në nivele të tilla në organet gjyqësore, që po krijohet nga procesi i vettingut. Vetëm gjatë fundit të Muajit Qershor 2019, KLGJ u vu në lëvizje për fillimin e miratimit të akteve rregullatore për vlerësimin e kandidaturave dhe procedurave të pranimit për personat që do të aplikojnë për në Gjykatën e Lartë.

[5] *71 ceshtje per trasferimet e perkohshme nga 449 ceshtje ne total per vitet 2018-2019.*

KLGJ pas një procesi transparent intervistimi dhe përzgjedhje propozoi 3 anëtarë për Gjykatën e Lartë, pranë Presidentit të Republikës të cilët janë dekretuar për të filluar detyrën. Por një çështje e paqartë në përllogaritjen e kuotave të shpërndarjes së vendeve në GJL mbetet numri i përgjithshëm i anëtarëve të këtij institucioni. Në kushtet kur KLGJ nuk ka disponuar ende me një vendim mbi caktimin e numrit te anëtarëve të GJL, në zbatim të Nenit 90 të Ligjit 98/2016 *"Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSH"* dhe kur numri i mëparshëm prej 19 anëtarësh nuk është në fuqi, del si detyrë përcaktimi i menjëhershëm i këtij numri, për të vijuar me vendime dhe projeksione të qarta mbi kuotat e shpërpjesëtuara të GJL të ndara midis anëtarëve gjyqtarë karriere dhe atyre jo gjyqtar. Gjithsesi zgjidhja e përkohshme që ju dha nga ana e KLGJ-së plotësimit të përkohshëm të vakumit të Gjykatës së Lartë me gjyqtarë të apelit, mbetet një precedent mjaft i dyshimtë dhe në raport mjaft kritik me dispozitat kushtetuese dhe ligjore në fuqi.

3. Lidhur me cilësinë e vendimeve të tjera të marra nga KLGJ në mënyrë kronologjike, veçojmë se në mbledhjet e para të zhvilluara gjatë vitit 2018[6], KLGJ e sapo konstituuar, krahas zgjedhjes së Kryetarit dhe Zv. Kryetarit ka konsideruar si vendime të rëndësishme për të filluar veprimtarinë , ato që kanë patur tematikë në lidhje me caktimin e rregullave për zgjedhjen e zv. kryetarëve të gjykatave, emërimin e të diplomuarve të Shkollës së Magjistraturës dhe caktimin e përkohshëm të gjyqtarëve të Gjykatës së Krimeve të Rënda që do të shprehin interes për të punuar në Gjykatën Speciale kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit.

   Gjatë mbledhjeve të Muajit Janar 2019, KLGJ është fokusuar, krahas të tjerash, për të krijuar komisionet e posaçme të tij, të cilët do të kenë autoritetit për të diskutuar, hartuar dhe përcjellë në seancë plenare për vendim, projekte të KLGJ sipas fushave përkatëse.

   Konkretisht këto komisione me natyre të përhershme janë si vijon[7]:

   - Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit:
   - Komisioni Disiplinor
   - Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale;
   - Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

   Po ashtu KLGJ ka miratuar edhe disa Komisione me natyre të përkohshme të cilat janë:

   - Komisioni i përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kritereve të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë
   - Komisioni i përkohshëm për vlerësimin etik dhe profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve

[6] *Mbedhet e dates 20;21 dhe 27 Dhjetor 2018*
[77] *Vendimi Nr.13 date 18.01.2018*

- Komisioni i përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të kryeinspektorit të ish- këshillit të lartë të drejtësisë
- Komisioni për Vlerësimin e Statusit Individual dhe Karrierën e Inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë

4. KLGJ ka marrë disa vendime, jo vetëm për të përcaktuar numrin e kandidatëve që do të pranohen në Shkollën e Magjistraturës si gjyqtarë , por edhe lidhur me procedurat e delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarëve.

   Gjatë Muajit Shkurt 2019, KLGJ ka trajtuar krahas të tjerash, çështje lidhur me rregulloret e funksionimit të komisioneve të mësipërme, krijimin e një komisioni të veçantë për trajtimin e ankesave ndaj vendimeve të ish-Nënkryetarit te KLD, si dhe të caktimit të rregullave për praktikën profesionale të studentëve magjistratë.

   Gjatë Muajit Mars 2019, KLGJ, është fokusuar më tepër në çështje të vendimmarrjes administrative për dhënien e disa lejeve afatgjatë të gjyqtarëve, në miratimi e një rregulloreje të veçantë për trajtimin e ankesave ndaj vendimmarrjes së ish-Nënkryetarit të KLD, si dhe për lejimin e disa transferimeve të përkohshme të gjyqtarëve për nevoja pune.

   Muaji Prill 2019, është periudha ku në dallim nga fluksi i muajve të mëparshëm të funksionimit të KLGJ, janë shënuar vetëm 2 mbledhje në dy javët e fundit të këtij muaji, të cilat kanë trajtuar kryesisht çështje për deklarimin e mbarimit të mandatit të disa anëtarëve të Gjykatës së Lartë , transferimin sërish të disa gjyqtarëve për mbulimin e çështjeve gjyqësore në gjykata të tjera.

   Gjatë Muajit Maj 2019, KLGJ ka marrë vendim për detajimin e shpërndarjes së punonjësve administrative pranë gjykatave. Gjithashtu ka trajtuar leje të papaguara të disa gjyqtarëve dhe ka vijuar me vendimet për transferimet e përkohshme të gjyqtarëve.

   Gjatë Muajit Qershor 2019, krahas disa vendimeve për transferimet e përkohshme të gjyqtarëve dhe vlerësimit të kushteve për emërim të kandidatëve për gjyqtar të magjistraturës, KLGJ filloi të trajtojë me përqendrim më të lartë çështjet e fillimit të shqyrtimit të teknikaliteteve për plotësimin e vakancave në Gjykatën e Lartë, duke u fokusuar në renditjen e kandidatëve jo gjyqtarë. Praktika e përzgjedhjes rezultoi pozitive, por procesi mori shumë më teper kohë sesa do të duhej. Nevoja që të kemi Gjykatë të Lartë të plotë e funksionale është përgjegjësi e duhet të jetë prioritet i secilës strukturë të organeve të reja të drejtësisë ose institucioneve të ngarkuara nga Kushtetuta.

- Gjatë Muajit Korrik 2019, KLGJ në disa vendimmarrje të tij, bëri shpalljen e procedurës së emërimit për në Gjykatën e Lartë nga radhët e *juristëve të spikatur*, si dhe trajtoi miratimin e kualifikimit dhe emërimet e një sërë studentëve të Shkollës së Magjistraturës në detyrat pranë gjykatave respektive.

- Gjatë Muajit Shtator 2019 KLGJ ka filluar të shqyrtojë aplikimet e paraqitura për anëtarë në GJL, e cila ka zënë pjesën më të madhe të aktivitetit të mbledhjeve dhe miratime të tjera të procesverbaleve të mbledhjeve.

- Gjatë Muajit Tetor 2019 KLGJ ka miratuar disa dokumente normative mbi kriteret që do të ndiqeshin për konkurrimin e kandidatëve për në GJL, transferimin në Gjykatën e Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit të disa gjyqtarëve nga gjykata të tjera, komandime të disa gjyqtarëve në disa pozicione si këshilltar pranë komisioneve në KLGJ etj.

- Gjatë Muajit Nëntor 2019 KLGJ ka shqyrtuar raportet periodike të paraqitura nga Kryetarët e Gjykatave dhe si volum qendror ka qenë përzgjedhja dhe zhvillimi i disa procedurave ndaj kandidatëve të paraqitur për të garuar për anëtarë të GJL.

- Gjatë Muajit Dhjetor 2019 KLGJ ka vijuar me transferimet e përkohshme të gjyqtarëve në gjykata të tjera, me detajimin e disa fondeve buxhetore dhe rishpërndarjen e tyre, në miratimit e programeve të vlerësimeve etike dhe profesionale për vitin 2020 etj.

- Gjatë Muajit Janar 2020 KLGJ ka trajtuar çështjet për miratimin e trajnimeve të gjyqtarëve, kritereve për emërimin e kancelarit të GJL, kalimin e përkohshëm te disa gjyqtarëve për gjykime në gjykata të tjera dhe transferimin në Gjykatën e Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit të disa gjyqtarëve nga gjykata të tjera.

- Gjatë Muajit Shkurt 2020 KLGJ është fokusuar në çështje që kanë patur lidhje kryesisht me detajimin e buxhetit të institucionit, emërime në disa komisione të përkohshme pranë tij, zhvillimin e seancave dëgjimore me kandidatët për GJL etj.

5. Lidhur me informimin publik dhe garantimin e mekanizmave të aksesit në informacion, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka krijuar një faqe te re zyrtare online, e cila prezantohet e pranueshme në standarde, bazuar në rubrikat informuese që ofron. Faqja online përmban programin e transparencës ndaj publikut, regjistrin online të kërkesave për informacion, formularin tip të kërkesës për informacion dhe të dhëna të tjera për të interesuarit. KLGJ ofron në rang drejtorie shërbimin dhe organizimin e marrëdhënies me publikun, si dhe ka ngarkuar njërin prej

anëtarëve të tij me detyrën për të mbikëqyr këtë veprimtari në institucion[8], krahas koordinatorit për të drejtën e informimit.

Personeli i përgjithshëm me status nëpunësi i KLGJ-së është i strukturuar në 4 Departamente, 8 Drejtori dhe 14 Sektorë. Referuar fushës së veprimit të KLGJ-së dhe specifikave të veprimtarisë së saj, numri i përgjithshëm i personelit dhe në veçanti i drejtorive paraqitet i lartë dhe i pajustifikuar mjaftueshëm. Trajtimi financiar i personelit civil bëhet sipas kategorisë ekuivalente me institucioneve të tjera të pavarura kushtetuese.

Me çeljen e buxhetit për vitin 2019 dhe 2020, KLGJ ka vijuar të përmbushë në mënyrë të plotë nevojat institucionale dhe logjistike. Transferimi në godinën e re të Pallatit të Drejtësisë krijoi premisa për plotësimin me ambiente pune të përshtatshme dhe sipas të gjitha standardeve bashkëkohore, por që nuk është realizuar ende. Problematikë mbetet mos parashikimi në buxhet i një fondi të veçantë për transferimin e pajisjeve dhe dokumentacionit zyrtar.

[8] *Vendimi Nr.68 dt.24.04.2019 "Per caktimin e anëtarit për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhënien me publikun".*

Rekomandime kryesore

- ✓ Miratimi sipas afateve ligjore të hartës gjyqësore në funksion të detyrimit ligjor, por edhe të nevojës për një qasje më strategjike në sistemin gjyqësor
- ✓ KLGJ duke qënë organi qeverisës i gjyqësorit duhet të ushtrojë detyrat e tij në mënyrë me vizionare në perputhje dhe me Planin Strategjik të miratuar. Një ndër funksionet kryesore të KLGJ është të marrë masa për të garantuar funksionimin me eficencë të sistemit gjyqësor. Per kete nevojitet plotesimi sa me pare i vakancave ne Gjykaten e Larte dhe ne gjykatat e apelit dhe te rretheve gjyqesore. Gjithashtu, ne fokusin primar te KLGJ duhet te jete marrja e masave per te minimizuar ngarkesen e gjyqtareve te gjykatave me te ulta si rrjedhoje e vakancave te krijuara per shkak te shkarkimeve apo doreheqjeve te gjyqtareve si pasoje e procesit te vettingut
- ✓ Si vleresohet nga ana juaj, bashkepunimi i KLGJ me aktoret e sistemit si dhe me grupet e interesit/organizatat e shoqerise civile per konsultimin e akteve me karakter normativ (efekt rregullues te sistemit) me interes te larte publik? Caktimi i numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Gjykatës së Lartë për të vijuar në mënyrë të rregullt përzgjedhjen e tyre sipas kuotave që përcakton ligji;
- ✓ Publikimi i mendimeve kundra me shkrim që është paraqitur nga anëtarë të veçantë gjatë vendimmarrjes;
- ✓ Hartimin e një plani për mbarëvajtjen e veprimtarisë së KLGJ-së në drejtim të planifikimit dhe organizimit më të efektshëm të pushtetit gjyqësor në përballimin e shërbimeve publike të kërkuara dhe të impaktit nga procesi i vettingut;
- ✓ Hartimin e një rregulloreje të re të brendshme të KLGJ, si dhe të Kodit Etik;
- ✓ Njoftimet e mbledhjeve ndaj personelit monitorues të kryhen në interval kohor më të gjatë nga zhvillimi i tyre dhe monitoruesve tju mundësohet akses paraprak në projekt-aktet që do të shqyrtohen;
- ✓ Mundësimi i një shpërndarje më të ekuilibruar në shtrirje periodike kohore të mbledhjeve dhe i ngarkesës për çdo njërën prej tyre.

MONITORIMI I KËSHILLIT TË LARTË I PROKURORISË

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) është një organ i rëndësishëm në sistemin e reformuar të drejtësisë shqiptare. Në datën 19.12.2018 u mbajt mbledhja e parë plenare dhe deri më sot KLP ka zhvilluar 50 të tilla. KLP-ja është organ kolegjial që përbëhet nga njëmbëdhjetë anëtarë. Aktualisht, ky organ përbëhet nga 9 anëtarë, dy anëtarë ("tre anëtarë" nëse do përfshijmë dhe shkarkimin e canit që ka ndodhur 1 javë mbas dorëzimit të raportit)nga radhët e prokurorëve janë shkarkuar nga detyra, si pasojë e procesit të vettingut. Janë katër shkarkimet e anëtarëve prokurorë për efekt të vettingut që nga krijimi i KLP-së.

Në situatën e krijuar, pritet që KLP-ja të fillojë procedurat për plotësimin e vakancave të krijuara në rradhët e prokurorëve dhe të finalizojë emërimet e dy anëtarëve të rinj. Gjatë këtyre muajve, me qëllim dhënien e një panorame sa më të plotë të punës së KLP-së, janë monitoruar mbledhjet plenare dhe faqja zyrtare e tij. Monitorimi është kryer duke mbajtur në konsideratë disa elementë sasiorë dhe cilësorë dhe zbatimin e legjislacionit përkatës. Më poshtë, janë të përmbledhura disa nga gjetjet dhe rekomandimet kryesore të punës së KLP-së, në vitin e parë të aktivitetit të tij.

1. Elementët sasiorë (çështje të formës dhe procedurës) që janë mbajtur në konsideratë për monitorimin e KLP-së

Neni 164 pika 1 e ligjit nr.115/2016 "*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*", përcakton se Këshilli duhet të mblidhet të paktën një herë në muaj. Nga monitorimi, konstatohet se KLP-ja është mbledhur më shumë se 1 herë në muaj. Kështu për shembull, gjatë muajit mars 2019, KLP ka zhvilluar 3 mbledhje plenare[9], ndërsa gjatë muajit prill 2019, Këshilli është mbledhur në 4 mbledhje plenare[10]. Shpeshtësia e mbledhjeve gjatë kësaj periudhe lidhet me faktin se në këto dy muaj puna e Këshillit është fokusuar në miratimin e akteve normative dhe procedurave të nevojshme për ngritjen e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (tani e tutje SPAK) dhe zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm, që janë përparësi të këtij institucioni. Deri tani mbledhjet plenare janë thirrur nga Kryetari i KLP-së, me përjashtim të dy mbledhjeve plenare, që janë thirrur nga Zv. Kryetari[11].

[9] *Në datën 6 mars është zhvilluar mbledhja e 7 plenare, me datë 19 mars është zhvilluar mbledhja e 8 plenare dhe me datë 25 mars është zhvilluar mbledhja e 9 plenare.*
[10] *Në datën 1 prill është zhvilluar mbledhja e 10 plenare, me datë 5 prill është zhvilluar mbledhja e 11 plenare, me datë 15 prill është zhvilluar mbledhja e 12 plenare dhe me datë 25 prill është zhvilluar mbledhja e 13 plenare.*
[11] *Mbledhja plenare nr. 24 datë 25.07.2019 dhe mbledhja plenare nr. 25 datë 02.08.2019.*

Përsa i përket volumit të çështjeve të trajtuara në mbledhjet plenare të KLP-së, këto variojnë nga njëra mbledhje në tjetrën, në varësi të punës dhe nevojave të Këshillit. Kështu për shembull, ka mbledhje plenare ku Këshilli ka diskutuar mbi 10 apo 11 pika të rendit të ditës dhe mbledhje të tjera plenare ku volumi i çështjeve ka qene mjaft i reduktuar dhe Këshilli ka diskutuar dhe vendosur vetëm mbi 1 ose 2 pika të rendit të ditës[12]. Nëse do i referohemi mesatarisht çështjeve, të shqyrtuara nga Këshilli në mbledhjet plenare, ato variojnë në rreth 5-6 çështje për mbledhje[13]. Duhet sqaruar se volumi i çështjeve të trajtuara nga Këshilli në mbledhje plenare jo gjithmonë i korrespondon kohës së nevojshme për të diskutuar dhe për të marrë vendime. Kështu për shembull, në mbledhjen plenare të mbajtur me datë 19 mars 2019, ku ishin parashikuar 5 pika në rendin e ditës, Këshilli ka diskutuar mbi 2 orë. Fokusi i diskutimeve në këtë mbledhje ishin dy draft-rregulloret "*Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë SPAK*" dhe "*Mbi kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm*".

Një praktikë e mirë e ndjekur deri tani nga Këshilli, ka qenë përcaktimi i një afati orientues në rendin e ditës, që i referohet kohës që mund t'i duhet anëtarëve të tij për të debatuar mbi argumentet e përcaktuara në të. Koha që ka marrë Këshilli për të diskutuar mbi pikat e rendit ka qenë efektive dhe vëmendja e anëtarëve mbi çështjet e shtruara për diskutim ka qenë e lartë, duke evituar zgjatjet e tepërta dhe të lodhshme.

Lidhur me procedurën e kryerjes së njoftimit për çdo mbledhje plenare të Këshillit, neni 164 pika 5 e ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", përcakton se është nën përgjegjësinë e Kryetarit të KLP-së respektimi i procedurave për njoftimin me shkrim të çdo anëtari, jo më vonë se 7 ditë përpara çdo mbledhje. Nga monitorimi i mbledhjeve plenare është konstatuar se herë pas here, ka patur pretendime nga anëtarë të Këshillit që, aktet mbi të cilët do të diskutohej në mbledhje u janë vënë në dispozicion me vonesë. Në këtë pikë duhet bërë një sqarim mbi çështjet që futen për herë të parë në rendin e ditës apo ato çështje të cilat kanë pësuar ndryshime gjatë mbledhjes dhe janë shtyrë për diskutim në mbledhjen e radhës dhe pikave të rendit të ditës që thjesht shtyhen për diskutim në mbledhjen e radhës.

Për pikat e rendit të ditës që pa ndryshime shtyhen për t'u diskutuar në mbledhjen e radhës, respektimi i afatit 7 ditë nuk është i nevojshëm. Ndërsa, për ato çështje të parashikuara në rendin e ditës që kanë pësuar ndryshime gjatë debateve në mbledhje plenare por shtyhen për miratim në mbledhjen plenare vijuese, rekomandohet që të respektohet afati i përcaktuar në ligj. Në këtë rast, të gjitha ndryshimet, ndonëse të debatuara në mbledhje t'u ridërgohen anëtarëve të Këshillit, që t'i jepet këtyre të fundit një informacion sa më i saktë që ndikon në vendimmarrjen e tyre. Këshilli, në

[12] *Në mbledhjen plenare nr. 12 mbajtur me datë 15.04.2019, Këshilli ka diskutuar për 11 çështje të ndryshme ndërsa në mbledhjen plenare nr. 23 datë 22.07.2019 Këshilli ka diskutuar për 10 çështje. Në mbledhjen plenare nr. 25 datë 02.08.2019, Këshilli ka diskutuar vetëm për 1 çështje ndërsa në mbledhjen plenare nr. 17 datë 17.06.2019 Këshilli ka diskutuar vetëm mbi 2 pika të rendit të ditës.*

[13] *Kështu për shembull, Këshilli në mbledhjen plenare nr. 14, ka shqyrtuar 5 çështje, në mbledhjen plenare nr. 11 datë 05.04.2019 ka shqyrtuar 3 çështje, në mbledhjen plenare nr. 21 datë 12.07.2019 ka shqyrtuar 9 çështje, etj.*

muajt e parë të aktivitetit të tij, ka operuar me një staf të reduktuar për shkak të miratimit me vonesë të buxhetit, por në vijim me plotësimin e stafit ndihmës, rekomandohet që njoftimi i rendit të ditës t'u vihet në dispozicion anëtarëve, të paktën 7 ditë përpara mbledhjes plenare.

Referuar vendosjes së njoftimit të mbledhjes plenare në faqen zyrtare të internetit të KLP-së vërehet se rendi i ditës së mbledhjeve plenare është publikuar të paktën 1 ditë përpara mbajtjes së mbledhjes. Rekomandohet që bashkë me publikimin e rendit të ditës të publikohen edhe draft-aktet mbi të cilat do të diskutojë Këshilli, veçanërisht aktet normative të një natyre të përgjithshme. Kështu për shembull, rregullorja "*Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë SPAK*" nuk është miratuar në versionin e parë të paraqitur për diskutim në mbledhje plenare. Draft-rregullorja ka pësuar ndryshime gjatë mbledhjes plenare të datë 19.03.2019, falë dhe propozimeve të anëtarëve të Këshillit, por nuk është publikuar në faqen online të këtij institucioni[14]. Në faqen zyrtare të KLP-së është publikuar vetëm versioni përfundimtar i rregullores së miratuar. Me qëllim respektimin e parimit të transparencës, rekomandohet që aktet normative të një natyre të përgjithshme, sikurse janë rregulloret, të publikohen edhe paraprakisht në formën e draft-akteve.

Gjatë monitorimit të mbledhjeve plenare të Këshillit është konstatuar se anëtarët e KLP-së rregullisht kanë marrë pjesë në mbledhje dhe kanë qenë aktiv në diskutimet e pikave të rendit të ditës, duke shprehur qartë qëndrimet e tyre. Kjo është e rëndësishme sepse kjo ndikon edhe në krijimin e kuorumit të nevojshëm për vendimmarrjen dhe vlefshmërinë e akteve të miratuara nga Këshilli.

Referuar procedurës së drejtimit të mbledhjeve plenare vërehet se moderimi i tyre nga Kryetari ka qenë, në përgjithësi, korrekt dhe i paanshëm. Si rregull, mbledhjet e Këshillit kanë filluar me leximin e pikave të rendit të ditës dhe më pas, Kryetari i mbledhjes ka shtruar për diskutim çështjet e parashtruara në të. Nga monitorimi konstatohet se anëtarëve u është dhënë në mënyrë të ekuilibruar koha për të diskutuar dhe për të shprehur qëndrimet e tyre mbi pikat e rendit të ditës. Megjithatë, vërehet se anëtarët janë të kujdesshëm dhe vetëpërmbahen gjatë referimeve të tyre. Nga deklarimet e vetë anëtarëve në mbledhjet plenare, konstatohet se anëtarët e Këshillit ndjekin praktikë për t'u mbledhur në mbledhje "jo formale". Në parim, takimet jo formale të anëtarëve janë pozitive nëse shërbejnë për t'u informuar apo për të shkëmbyer ide ndërmjet tyre. Por, mbledhjet "jo formale" nuk duhet të kthehen në praktikë konstante që paraprin mbledhjen plenare të KLP-së sepse mund të zhvlerësojë vetë rëndësinë e kësaj të fundit, duke e kthyer në një formalitet të padobishëm. Për më tepër, nëse në këto mbledhje "jo formale" merren vendime, atëherë mbajtja e procesverbalit bëhet i nevojshëm dhe në të duhet të pasqyrohen qëndrimet dhe argumentet e anëtarëve. Për këtë qëllim, do të ishte e nevojshme që mbledhjet jo plenare, e për pasojë jo publike të KLP-së, të rregullohen nga një rregullore e brendshme të Këshillit e cila qartëson modalitetet e thirrjes dhe të zhvillimit të tyre.

[14] *Në këtë mbledhje, rregullorja në fjalë është miratuar në tërësi nga të gjithë anëtarët.*

Një praktikë e mirë është ndjekur nga Kryetari i Këshillit në rastet kur gjatë mbledhjeve, anëtarët kanë diskutuar dhe kanë mbajtur qëndrime të ndryshme mbi një çështje të caktuar. Në fund të diskutimeve, Kryetari ka bërë një përmbledhje të të gjithë qëndrimeve të anëtarëve duke evidentuar argumentet pro dhe kundër. Evidentimi në mënyrë të përmbledhur të të gjitha qëndrimeve ndikon pozitivisht edhe në formimin e kuorumit të nevojshëm për vendimmarrjen. Rekomandohet, që një praktikë e tillë e mirë të vijojë edhe në mbledhjet e tjera. Gjithashtu, në respekt të pikës 5 të nenit 166, të Ligjit nr. 115/2016, rekomandohet që Kryetari të jetë i kujdesshëm që të mos votojë njëkohësisht me anëtarët e tjerë, por të votojë në fund, për shkak se vota e tij është përcaktuese.

Regjistrimet audio të mbledhjeve plenare të KLP-së janë publikuar të plota në faqen zyrtare të internetit të KLP-së, si rregull, të nesërmen e zhvillimit të mbledhjes. Gjithashtu, në faqen zyrtare online të KLP-së gjenden të publikuara vendimet e marra nga Këshilli, në rend kronologjik duke nisur nga vendimet e fundit deri tek ato më të hershme. Faqja zyrtare online e KLP-së është lehtësisht e aksesueshme dhe përditësohet mbas zhvillimit të çdo mbledhje plenare, duke i mundësuar çdo personi të interesuar marrjen e informacionit të kërkuar në kohë dhe pa vështirësi. Duke filluar nga janari 2020 vërehet një praktikë e mirë e ndërmarrë nga Këshilli referuar edhe publikimit të plotë të procesverbalit të mbledhjes plenare, një mangësi e evindetuar më parë nga aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile.

Pika 2 dhe 3 të nenit 167 e ligjit nr. 115/2016, përcakton se nën përgjegjësinë e Kryetarit, administrata duhet të bëjë kujdes që të fshijë referencat tek emrat konkret, me përjashtim të emrave të anëtarëve të Këshillit dhe emrave të prokurorëve, mbi të cilët janë vendosur masa disiplinore të pezullimit dhe të shkarkimit. Për të gjitha vendimet e tjera administrative individuale, rekomandohet që Këshilli të bëj kujdes dhe këto vendime të publikohen me inicialet e personave të cilëve ju drejtohet, dhe jo me emrin e plotë, në koherencë edhe me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë.

2. Elementë cilësorë (çështje të përmbajtës në vendimmarrje) që janë mbajtur në konsideratë për monitorimin e KLP-së

Planifikimi strategjik është procesi ndërveprues që një institucion, duhet të krijojë ndërmjet burimeve në dispozicion të tij dhe objektivave që dëshiron të realizojë. Në këtë kuadër, KLP duhet të planifikojë në mënyrë efikase burimet e tij financiare dhe njerëzore, me qëllim përmbushjen e pritshmërive, që për këtë institucion janë të larta. Për këtë qëllim, pas 15 muajsh nga krijimi i tij, rekomandohet që Këshilli të miratojë një planifikim strategjik afatmesëm të aktivitetit të tij duke identifikuar përparësitë e tij. Gjatë mbledhjes plenare të mbajtur me datë 6 mars 2019, KLP-ja miratoi strukturën e tij organizative, e cila do të përbëhet nga 65 persona. Ndërsa, në mbledhjen

plenare të mbajtur me datë 25 prill 2019, KLP miratoi me shumicë votash relacionin për projekt-vendimin "*Për miratimin e projekt buxhetit afatmesëm për vitin 2020-2022*" i hartuar nga Komisioni i Planifikimit Strategjik i Administrimit dhe Buxhetin e KLP-së. Në fillim të gushtit, KLP ka shpallur në faqen e saj zyrtare pozicionet vakante pranë këtij institucioni dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët. Në vijimësi, Këshilli në faqen e tij zyrtare ka publikuar vendet vakante dhe kriteret që duhet të përmbushin kandidatët.

- Miratimi, ndonëse me vonesë, i buxhetit dhe burimet njerëzore ndikojnë pozitivisht në performancën dhe në rritjen e cilësisë së këtij institucioni. Nga ana tjetër, Këshilli duhet të bëjë kujdes referuar kritereve që duhet të plotësojnë kandidatët. Duhet treguar kujdes që këto kriteret të mos jenë përjashtuese, por të krijojnë konkurrencë efektive ndërmjet tyre, duke bërë të mundur përzgjedhjen e kandidatëve më të përshtatshëm për detyrën që do t'i ngarkohet.

Në zbatim të nenit 160 të Ligjit nr. 115/2016, me vendimin nr. 6 datë 26.12.2018, KLP krijoi Komisionet e Përhershme[15]. Neni 168 i ligjit në fjalë, përcakton se Komisioneve të Këshillit u zbatohen për analogji rregullat e përcaktuara në nenet 164-167, që rregullojnë modalitetet për thirrjen dhe zhvillimin e mbledhjeve të KLP-së. Në mënyrë të veçantë, neni 167 i këtij ligji përcakton rregulla të qarta mbi dokumentimin e mbledhjeve të Komisioneve dhe transparencën e tyre, duke përcaktuar detyrimin për regjistrimin audio dhe bërjen publike në faqen zyrtare të KLP-së. Ky detyrim vlen edhe për procesverbalin që përmban përmbledhjen e diskutimeve të mbledhjes së Komisioneve, i cili përsëri duhet të bëhet publik.

- Nga monitorimi i vazhdueshëm, vërehet se Komisionet e Përhershme kanë zhvilluar mbledhje të mbyllura dhe vendimmarrja nuk është bërë publike, ndonëse konstatohet se volumi i punës së tyre ka qenë i lartë[16]. Komisionet luajnë një rol të rëndësishëm në punën përgatitore të akteve mbi të cilat bazohet vendimmarrja e Këshillit. Për këtë arsye, sikurse përcaktohet në pikën 2 të nenit 168 të ligjit nr. 115/2016 rekomandohet nevoja e miratimit të rregullave të detajuara për organizimin dhe funksionimin e tyre[17].

---

[15] *Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit; Komisioni Disiplinor; Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe Komisioni i zhvillimit të Karrierës.*

[16] *Kështu për shembull, sillet për ilustrim fakti se shpeshherë gjatë mbledhjeve plenare, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, nëpërmjet Kryetarit të tij ka prezantuar në Këshill relacione mbi veprimtarinë e prokurorëve kandidatë për caktimin e tyre të përkohshëm.*

[17] *Ligji ka bere rregullimin minimal te domosdoshem te cilin perseri KLP nuk e ka respektuar. Nderkohe vete dispozita ligjore ka nevoje per rregullim me akt normativ, psh, nje rregullore e brendshme, kur psh: nje anetar i komisionit qe kerkon te fus nje argument te ri tek mbledhja e parashikuar e keshillit si do te veproje? Do njoftoj kryeratin? Mund ta paraqese direkt ne mbledhje? A duhet ta miratojne anetaret e tjere?*

- Në këtë kuadër, rekomandohet që mbledhjet e Komisioneve të organizohen në mënyrë të tillë që të maksimalizojë kontributin e anëtarëve të tyre. Anëtarët e Komisioneve duhet të marrin pjesë aktive në diskutime dhe në procesin e vendimmarrjes së Komisionit. Kryetari i Komisionit është përgjegjës për t'u kujdesur që anëtarët e tij të marrin në kohë, informacion të saktë dhe të qartë.

- Pika 16 e nenit 160 të Ligjit nr. 115/2016, përcakton që brenda muajit janar të çdo viti kalendarik, secili Komision i Përhershëm paraqet një raport vjetor mbi veprimtarinë e tij. Rekomandohet që, në mënyrë të ngjashme, edhe për secilin anëtar të Komisionit të bëhet një vlerësim periodik bazuar në detyrat e ngarkuara dhe performancën e tij individuale.

- Rekomandohet përcaktimi i rregullave të qarta përsa i përket ndërveprimit ndërmjet Këshillit në tërësi dhe Komisioneve të veçanta të tij, të drejtën e një anëtari të Këshillit për të kërkuar dhe marrë informacion mbi një çështje të caktuar në diskutim pranë Komisionit, etj.

Një element tjetër që është mbajtur në konsideratë gjatë monitorimit është edhe përmbajtja dhe renditja e çështjeve të parashikuara në rendin e ditës. Përsa i përket radhës së veprimeve dhe respektimit të rendit të ditës, në përgjithësi, Këshilli ka qenë i kujdesshëm dhe ka diskutuar mbi pikat e parashikuara më parë në të. Duke qenë se rendi i ditës është akti kryesor nga i cili fillon e gjithë procedura dhe vlefshmëria e vendimeve të marra nga Këshilli, duhet patur kujdes në përcaktimin dhe renditjen e çështjeve të përmbajtura në të.

- Rekomandohet që të bëhet kujdes me pikën "*e të tjera*" të rendit të ditës. Kjo pikë duhet t'u shërbejë anëtarëve për të sqaruar pikat e paracaktuara në rendin e ditës dhe që lidhen drejtpërsëdrejti apo në mënyrë të tërthortë me çështje që nuk janë parashikuar shprehimisht tek pikat e rendit të ditës. Pika "*e të tjera*" nuk duhet të shërbejë si alternativë për të futur çështje të reja për trajtim, të cilat nuk janë njoftuar më parë me rendin e ditës.

- Futja e një pike të re në rendin e ditës duhet të shoqërohet me vendimmarrjen e të gjithë anëtarëve. Nga monitorimi i kryer është konstatuar se pikat e reja të rendit të ditës, së propozuara nga Kryetari apo nga anëtarët e KLP-së, janë futur në rendin e ditës me votën e shumicës së anëtarëve prezent. Rekomandohet, që kjo të bëhet në fillim të mbledhjes plenare dhe duke bërë ndryshimet përkatëse në rendin e ditës, i cili duhet të përditësohet me vendimin unanim të marrë nga të gjithë anëtarët e Këshillit. Në mungesë të këtij kuorumi, rendi i ditës nuk duhet të ndryshojë.

- Gjithashtu, rekomandohet që nëse Këshilli miraton ndryshimin e rendit të ditës, vendimi duhet të publikohet online dhe të jetë i aksesueshëm duke ndjekur të njëjtën praktikë të përcaktuar për publikimin e vendimeve të tjera të marra nga Këshilli.

- Praktikë e mirë e ndërmarrë së fundmi nga Këshilli është miratimi i procesverbaleve të mbledhjes plenare së fundit në fillim të mbledhjes plenare të radhës, duke u dhënë mundësi anëtarëve të verifikojnë korrektësinë e mbajtjes së procesverbalit në respekt të parimit të transparencës.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i mbajtur në konsideratë gjatë monitorimit është dhe argumentimi i anëtarëve të KLP-së të çështjeve të ndryshme të shtruara për diskutim si dhe mënyra e dokumentimit të këtyre qëndrimeve.

- Në respekt të parimeve të mirëqeverisjes, rekomandohet që qëndrimet kundër dhe argumentimi i tyre të publikohen në vendimin përfundimtar të Këshillit, në mënyrë të ngjashme me vendimet e dhëna nga Gjykata e Lartë. Kjo praktikë të zbatohet veçanërisht në rastet kur Këshilli është i ndarë në vendimmarrjen e tij dhe vetëm vota e Kryetarit bën diferencën. Në këtë mënyrë, jo vetëm respektohet parimi i transparencës, por anëtarët do të jenë më të ndërgjegjshëm dhe të kujdesshëm në shprehjen e votës së tyre. Për më tepër, pika 9 e nenit 164 e Ligjit nr. 115/2016, përcakton shprehimisht të drejtën e anëtarëve të pakicës që të kërkojnë që opinioni i tyre t'i bashkëngjitet vendimit të Këshillit, kur ky i fundit merr vendime administrative individuale. Deri tani konstatohet se anëtarët e Këshillit, që kanë pasur qëndrime të ndryshme nga shumica dhe kanë votuar kundër për një çështje të caktuar, nuk e kanë ushtruar të drejtën e parashikuar në nenin 164 pika 9 e Ligjit nr. 115/2016 .

Ndër prioritetet kryesore të KLP-së është ngritja e SPAK dhe përzgjedhja e Prokurorit të Përgjithshëm. Në datë 19 mars 2019, KLP diskutoi mbi dispozitat e projekt-rregullores "*Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë SPAK*"[18]dhe krijimin e një *Komisioni të posaçëm*[19] me anëtarë të KLP-së, i cili vlerësoi paraprakisht verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për ngritjen në detyrë të kandidatëve që konkurrojnë për SPAK. Në mbledhjen plenare të datës 25 nëntor 2019, Këshilli vendosi të miratojë, në unanimitet, emërimet e tetë prokurorëve në SPAK, që kanë përmbushur procesin e vettingut. Vendimi i emërimit të tyre hyri në fuqi me datë 19 dhjetori 2019, ditë kur u realizua betimi përpara Presidentit të Republikës. Gjithashtu, në mbledhjen e datës 25 nëntor 2019, bazuar tek neni 18 i Rregullores "*Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë SPAK",* KLP vendosi t'i drejtojë prokurorëve të SPAK një kërkesë për shprehje interesi për pozicionin e drejtuesit të SPAK. Në këtë mënyrë, Këshilli vendosë të hapë

[18] *E miratuar me vendimin nr. 51 datë 19.03.2019.*

[19] *Në bazë të nenit 11 të Rregullores "Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë prokurorisë së posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar", Komisioni i Posaçëm përbëhet nga 5 anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, prej të cilëve 3 anëtarë prokurorë dhe 2 anëtarë joprokurorë. Anëtarët e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës janë ex officio anëtarë të Komisionit të Posaçëm. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale përjashtohen ex officio nga pjesëmarrja në Komisionin e Posaçëm. Dy anëtarët e tjerë të Komisionit të Posaçëm, njëri prej të cilëve anëtar prokuror dhe tjetri anëtar jo prokuror, zgjidhen me short nga pjesa e mbetur e anëtarëve të Këshillit.*

garën për postin e drejtuesit të SPAK. Kandidatët e interesuar kanë patur 15 ditë kohë, deri me datë 10 dhjetor 2019, për të aplikuar. Në këtë mbledhje, Këshilli vendosi me shumicë votash miratimin e metodologjisë për vlerësimin e kandidatëve për drejtues të SPAK. Kjo metodologji bazohet tek kriteret e përcaktuara nga ligji nr. 95/2016. Në mbledhjen plenare të mbajtur me datë 12 dhjetor 2019 që përkon me datën e krijimit të SPAK, Këshilli, në unanimitetin e anëtarëve të tij vendosi transferimin e prokurorëve të Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda dhe të Apelit për Krimet e Rënda në Prokuroritë e Shkallës së Parë dhe ato të Apelit në vend, si pasojë e mbarimit të ekzistencës së Prokurorisë së Shkallës së Parë dhe të Apelit për Krimet e Rënda. Për këtë qëllim, Këshilli përdori mekanizimin e caktimit të përkohshëm të prokurorëve, veprim që mund të shihet në mënyrë kritike, pasi lë vend për diskrecion dhe mund të krijojë probleme me dosjet në hetim të prokurorëve. Ndërkohë, në mbledhjen plenare të mbajtur me datë 19 dhjetor 2019, Këshilli zgjodhi me shumicë votash kryetarin e SPAK ndër tre kandidatët që kishin shprehur interes.

- Rregullorja "*Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë SPAK*" është miratuar mbas mbylljes së afatit për dorëzimin e kërkesave nga kandidatët e interesuar për të aplikuar në pozicionet vakante në SPAK. Praktikat e mirëqeverisjes sugjerojnë që fillimisht duhet të miratohen kriteret kualifikuese dhe procedura standarde që organi kompetent duhet të respektojë për përzgjedhjen e kandidatëve, dhe vetëm më pas, të bëhet thirrja për aplikim. Në këtë mënyrë, garantohet parimi i transparencës dhe barazisë në garë, sepse apriori evitohet çdo pretendim, qoftë dhe hipotetik, për krijimin e kritereve *ad hoc* që mund të ndihmojnë një kandidat të caktuar.

- Një element i rëndësishëm i procedurës i cili duhet të mbahet në konsideratë nga Këshilli, lidhet me respektimin e afateve. Këshilli, gjatë procedurës për ngritjen e SPAK, në dy momente vendosi për shtyrjen e afatit të paracaktuar. Me datë 7 janar, KLP me vendimin nr.10/1 vendosi shpalljen e 15 pozicioneve vakante pranë SPAK si dhe përcaktoi datën 7 shkurt si afat përfundimtar për dorëzimin e aplikimeve të kandidatëve të interesuar. Në datë 6 shkurt 2019, KLP në mbledhje plenare, vendosi[20] shtyrjen e afatit për dorëzimin e aplikimeve nga data 7 shkurt në datën 21 shkurt 2019. Ndërsa, gjatë mbledhjes të mbajtur me datë 13.05.2019, KLP me propozim të Kryetarit dhe me shumicë votash[21], vendosi që të shtyjë me 3 javë afatin në dispozicion të Komisionit të Posaçëm, për shqyrtimin e dosjeve të kandidatëve për SPAK, për shkak të volumit të tyre. Afati i paracaktuar për dorëzimin e aplikimit të kandidatëve të interesuar, në vetvete, përbën një ndër kriteret përzgjedhës të kandidatëve që aplikojnë. Për këtë arsye, ky afat nuk duhet të shtyhet. Gjithashtu, KLP-ja, duhet të ketë kujdes edhe në përcaktimin e afateve gjatë hallkave të ndryshme të procedurës së përzgjedhjes, sepse si e tillë kjo e fundit duhet të respektohet pa ndryshime. Për këtë qëllim, rekomandohet që Këshilli, në situata të tilla të ngjashme, të tregojë kujdesin e nevojshëm dhe të përllogarisë paraprakisht të gjithë kohën që i nevojitet për përmbushjen e një detyre të caktuar, për të evituar ripërtëritjen e afatit.

[20] *Me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm (10 anëtar dhe 1 votë kundër).*
[21] *10 vota pro dhe 1 kundër.*

- Neni 148/dh i Kushtetutës së Shqipërisë, shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, në pikën 2 të tij, qartësisht përcakton se SPAK duhet të përbëhet nga të paktën 10 prokurorë. Me datë 26 dhjetor 2020, KLP pranoi me shumicë votash[22] kërkesën e drejtuesit të SPAK për transferimin e përkohshëm të dy prokurorëve nga Prokuroria e Përgjithshme në SPAK. Në mbledhjen plenare të mbajtur me datë 27 janar, KLP vendosi me shumicë votash fillimin e procedurave për plotësimin e dy vendeve vakante në këtë prokurori. Ndërsa në datën 31 janar 2020, KLP, në mbledhje plenare emëroi edhe një prokuror, mbasi ky i fundit kishte përfunduar procedurën e vettingut. Duke patur në konsideratë, rëndësinë dhe rolin e SPAK, si një ndër institucionet më të rëndësishme të reformës në drejtësi, rekomandohet që të tregohet kujdes në respektimin e procedurave ligjore dhe kritereve që duhet të përmbushin prokurorët që do të emërohen në këtë prokurori.

- Referuar procedurës për përzgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm, KLP me vendimin nr. 50 datë 19.03.2019 miratoi Rregulloren "*Mbi kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e kandidatit për Prokuror të Përgjithshëm*". Këshilli bën vlerësimin paraprak, me qëllim verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore, por në ndryshim nga SPAK, Këshilli, në tërësinë e anëtarëve të tij, bëri vlerësimin paraprak të kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm. Për vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm, KLP në 12 nëntor 2019 me vendimin nr. 229, miratoi metodologjinë orientuese për vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm. Mbas diskutimeve të shumta mbi natyrën juridike të këtij akti, Këshilli, në unanimitetin e tij, vendosi që ky akt të jetë i një natyre jo detyruese por vetëm orientues, me qëllim lehtësimin e punës së anëtarëve të Këshillit në vlerësimin dhe në renditjen e kandidatëve të përzgjedhur.

- Vlerësimi i kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm u bazua në katër kritere që kanë në fokusin e tyre aftësitë profesionale, integritetin, aftësitë drejtuese dhe aftësi të tjera. Në vijimësi, sikurse përcakton edhe neni 19 pika 1 e Rregullores "*Mbi kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm*", Këshilli zhvilloi intervistat me kandidatët, intervista të cilat u transmetuan në kohë reale nga televizione të ndryshme kombëtare. Me datë 14 nëntor, Këshilli, në unanimitetin e tij, vendosi renditjen e kandidatëve, duke zgjedhur në këtë mënyrë edhe Prokurorin e Përgjithshëm të parë mbas reformës në drejtësi.

- Grupi i ekspertëve vlerëson se ky proces ishte pozitiv megjithëse gjatë fazave të ndërmjetme mungoi transparenca dhe standardizimi për vlerësimin e dhënë nga anëtarët e Këshillit për kandidatët. Për shembull, u publikuan vetëm rezultatet finale pa pikët e dhëna individualisht nga secili anëtar i KLP-së dhe argumentimi i pikëve të dhëna. Vlerësimi i kandidatëve me diferencë pikësh nga 0 në 10 meriton një shpjegim.

[22] *9 vota pro dhe 1 kundër.*

- Nga diskutimet e anëtarëve në mbledhje plenare, konstatohet se Rregullorja "*Mbi kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e kandidatit për Prokuror të Përgjithshëm*" ka pësuar ndryshime në disa dispozita të saj, si p.sh. neni 2 i Rregullores. Këto ndryshime nuk kanë ndodhur gjatë mbledhjeve plenare të Këshillit. Në mungesë të një rregulloreje të brendshme që normon aktivitetin e Këshillit, rekomandohet që të gjitha ndryshimet mbi aktet normative të miratuara nga Këshilli të bëhen në mbledhje plenare dhe të jenë të publikuara online, në respekt të parimit të transparencës dhe informimit të publikut, si një ndër hallkat kryesore të reformës në drejtësi.

- Në dallim nga gara për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë SPAK në garën për Prokuror të Përgjithshëm mund të kandidojnë edhe personat që nuk vijnë nga radhët e prokurorëve. Për këtë arsye, KLP ka vendosur që në mënyrë të ngjashme sikurse ndodh për kandidatët që kalojnë në procesin e vettingut të ndërmarrë hapa për verifikimin e burimit të pasurisë, të integritetit moral dhe profesional bazuar tek informacionet e marra nga institucionet shtetërore përkatëse. Kjo është një praktikë e mirë e Këshillit me qëllim trajtimin në mënyrë të barabartë të të gjithë kandidatëve që garojnë për postin e Prokurorit të Përgjithshëm.

- Një praktikë e mirë e vënë në jetë nga Këshilli lidhet me miratimin e metodologjinë orientuese për vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm. Një dokument të ngjashëm, Këshilli e ka miratuar edhe për përzgjedhjen e kandidatëve për SPAK. Rekomandohet që në proceset e ardhshme që do të ndërmarrë KLP, anëtarët të argumentojnë në mënyrë individuale dhe të detajuar vlerësimet e bëra prej tyre mbi kandidatët në garë. Gjithashtu, rekomandohet që vlerësimet individuale të secilit nga anëtarët e Këshillit, bashkangjitur dhe motivimi i vlerësimit të publikohet në faqen zyrtare të KLP. Në këtë mënyrë, anëtarët do të jetë më të kujdesshëm në përmbushjen e detyrave të tyre. Transparenca e vlerësimit dhe motivimi i tij do të ndikonte pozitivisht në evitimin e konfliktit të interesit apo të praktikave të pakëndshme të mos dhënies së pikëve të merituara një kandidati me qëllim favorizimin e një kandidati tjetër. Përsëri, do të rekomandohej që metodologjia të jetë një akt normativ detyrues dhe jo vetëm i një natyre orientuese.

- Me vendimin nr. 64, datë 15.04.2019, KLP miratoi rregulloren "*Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve*"[23]. Kjo rregullore lindi, në kushte të emergjencës, si mekanizëm për të përballuar shkarkimet e shpeshta që vinin si pasojë e vettingut[24]. Si një akt normativ i miratuar në kushte të emergjencës, ky akt duhet të jetë i zbatueshëm në një afat të përcaktuar dhe Këshilli të orientohet drejt emërimeve përfundimtare. Ndërkohë, me vendimin nr. 78, datë 04.03.2020, Këshilli vendosi se mund të caktojë përkohësisht një prokuror më shumë se katër herë në të njëjtin pozicion ose në

[23] http://klp.al/wp-content/uploads/2019/04/Nr.64-Dat%C3%AB-15.04.2019.pdf
[24] *Për më shumë shih disktutimet e mbledhjes plenare të mbajtur me datë 01.04.2019.*

një pozicion tjetër[25]. Në këtë mënyrë, ripërtëritja e afatit të caktimit të përkohshëm të prokurorit po kthehet në një mekanizëm të zakonshëm të përdorur nga Këshilli që humbet elementet e emergjencës dhe zgjeron në mënyrë diskrecionale kompetencat e KLP-së për të ndërhyrë në emërimet e prokurorëve.

- Në mbledhjen plenare të datës 11.02.2020, në rendin e ditës, pika 9 e tij, Këshilli kishte përcaktuar të diskutonte dhe të miratonte Rregulloren "*Mbi kriteret dhe procedurën e ngritjes në detyrë në shkallët më të larta dhe në pozicionin drejtues në prokurori*". Por kjo çështje u tërhoq nga rendi i ditës me kërkesë të shumicës së anëtarëve të Këshillit[26]. Ndërsa, me vendimin nr. 171, datë 27.09.2019, Këshilli ka miratuar Rregulloren "*Për procedurat e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicionin e kandidatëve për prokuror, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve*". Këto rregullore do të ndikojnë pozitivisht në rritjen e cilësisë së kritereve në përzgjedhjen e prokurorëve dhe në emërimet përfundimtare të tyre.

- Nga monitorimi, konstatohet një përdorim i shpeshtë i caktimit të përkohshëm të prokurorëve. Rekomandohet që Këshilli të jetë i kujdesshëm në interpretimin e ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Këshilli, duke patur në konsideratë gjendjen e prokurorisë, duhet të përdorë sa më pak këtë mekanizëm dhe të orientohet në emërime përfundimtare të prokurorëve. Kjo do të ndikonte në motivimin dhe në cilësinë e punës së tyre.

- Me qëllim trajtimin e barabartë të të gjithë prokurorëve, rekomandohet kujdes nga Këshilli që të zbatojë të njëjtat standarde dhe parime për prokurorët që ndodhen në të njëjtat kushte, për të evituar standarde të dyfishta që cenojnë besueshmërinë e këtij institucioni. Kështu për shembull, në mbledhjen plenare të zhvilluar me datë 15.04.2019, KLP vendosi caktimin në detyrë të një prokurori pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë Tiranë edhe pse subjekti në fjalë sapo ishte emëruar prokuror. Ndërkohë, në mbledhjen plenare të datës 12.06.2019, në prag të emërimit të magjistratëve të rinj si prokuror, Këshilli vlerësoi se Prokuroria e Tiranës dhe e Durrësit të vlerësohen si prokurori karriere dhe për magjistratët e rinj, emërimi të bëhet vetëm në vendet vakante dhe efektive në rrethe.

[25] *Neni 3 pika 3 e Rregullores"Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve" përcakton se "Këshilli nuk mund të caktojë përkohësisht një prokuror më shumë se katër herë në të njëjtin pozicion ose në një pozicion tjetër", ndërsa neni 4 pika 1 përcakton se "Në rastet kur një prokuror me pozicion të përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për një periudhë jo më shumë se tre muaj, drejtuesi i prokurorisë vë në dijeni Këshillin për këtë situate".*

[26] https://klp.al/2020/02/11/vendime-te-marra-ne-seancen-plenare-11-shkurt-2020/

3. Përfundime

Në këtë prezantim të shkurtër të monitorimit të punës një vjeçare të KLP-së, vëmendja është përqendruar tek zbatimi i legjislacionit në fuqi, evidentimi i problematikave kryesore dhe dhënia e disa rekomandimeve me qëllim përmirësimin e performancës së këtij institucioni. Miratimi me vonesë i buxhetit apo mungesa e personelit ndikojnë tek performanca e Këshillit, megjithatë nuk kanë munguar edhe konstatimi i iniciativa pozitive të ndërmarra prej tij. Në mënyrë të përmbledhur më poshtë sillen disa nga gjetjet pozitive të konstatuara gjatë aktivitetit të Këshillit dhe disa rekomandime që i adresohen për përmirësimin në aktivitetin e tij të ardhshëm.

3.1 GJETJE POZITIVE

- KLP, në përputhje me nenin 35 pika 1, shkronja c dhe neni 32 pika 2-6 të ligjit nr. 96/2016 "*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*", ka kryer vlerësimin mbi pasurinë dhe figurën e kandidatëve prokuror që kanë mbaruar magjistraturën dhe ishin në pritje të emërimit të tyre. Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale ka hartuar një raport të detajuar për çdo kandidat bazuar mbi informacionin e marrë nga institucionet shtetërore përkatëse dhe ka kryer kontrollin paraprak të pasurisë dhe figurës së kandidatëve prokuror. Komisioni, në hartimin e raporteve të kandidatëve prokuror ka zbatuar *parimin e proporcionalitetit* si dhe ka mbajtur në konsideratë deklaratat e bëra nga kandidatët mbi informacionet shtesë të kërkuara.
- KLP-ja me vendimin nr. 91 datë 13 naj 2019 ka miratuar rregulloren "*Për pagesat e prokurorëve për punën e kryer jashtë orarit zyrtar*", efektet financiare të së cilës do të fillojnë të zbatohen nga data 1 janar 2019. Kompensimi financiar për angazhimin dhe ngarkesën e prokurorëve jashtë orarit zyrtar është një vlerësim për punën e tyre dhe si e tillë do të ndikojë pozitivisht në përmbushjen e detyrave të ngarkuara.
- KLP-ja ka miratuar rregulloren "*Për veprimtaritë jashtë funksionit të Prokurorëve*"[27] e cila normon të drejtën e prokurorëve për t'u angazhuar në aktivitete të tjera si mësimdhënie, publikime etj. Kjo rregullore përcakton qartë parimet, kushtet dhe procedurën mbi të cilën do të bazohet Këshilli, për lejimin e ushtrimit të veprimtarive jashtë funksionit të prokurorëve të interesuar, e cila nuk mund të jetë më shumë se 2 orë në javë gjatë orarit të punës.
- Një aspekt pozitiv i punës së deritanishme të KLP-së lidhet me lehtësinë e marrjes së informacionit në faqen zyrtare të internetit të KLP-së. Lehtësia e aksesit në këtë faqe dhe gjetja pa vështirësi e informacionit të kërkuar ndikon pozitivisht në transparencën e punës së këtij institucioni.

[27] *http://klp.al/wp-content/uploads/2019/05/RREGULLORE-P%C3%8BR-PAGESAT-E-PROKUROR%C3%8BVE-P%C3%8BR-PUN%C3%8BN-E-KRYER-JASHT%C3%8B-ORARIT-ZYRTAR.pdf*

3.2 REKOMANDIME

- Këshilli, edhe pse ka miratuar disa rregullore të rëndësishme, ende nuk ka miratuar një rregullore të brendshme që është domosdoshmëri për zbatimin e parimeve të mirëqeverisjes. Miratimi sa më parë i një rregulloreje të brendshme do të ndihmonte në formalizimin e marrëdhënieve ndërvepruese ndërmjet anëtarëve dhe Këshillit, këtyre të fundit dhe Komisioneve të Përhershme apo marrëdhënieve ndërmjet Këshillit në tërësi dhe Komisioneve të tij si dhe do t'i shërbente mirë funksionimit dhe efiçencës së këtij institucioni. Në kuadër të miradministrimit dhe efikasitetit rekomandohet që Këshilli të miratojë dhe një planifikim strategjik afatmesëm.
- Komisionet e përhershme luajnë një rol parësor dhe të rëndësishëm në administrimin e akteve dhe të informacioneve të nevojshme për përgatitjen e raporteve dhe relacioneve të ndryshme mbi të cilat bazohet vendimmarrja e Këshillit. Për këtë arsye, në zbatim të ligjit nr. 115/2016 dhe parimit të transparencës rekomandohet që mbledhjet e Komisioneve të jenë të hapura dhe vendimet e tyre të pasqyrohen në faqen e internetit të këtij institucioni. Gjithashtu, rekomandohet që për secilin anëtar të Komisionit të bëhet një vlerësim periodik bazuar në detyrat e ngarkuara dhe performancën e tij individuale.
- Në respekt të parimit të transparencës dhe barazisë në garë, rekomandohet që në punën vijuese të tij, Këshilli të tregojë kujdes që të miratojë paraprakisht rregullat procedurale dhe materiale referuar një gare të caktuar, dhe vetëm më pas, të fillojë gara apo përzgjedhja e kandidatëve më të përshtatshëm për atë pozicion. Gjithashtu, Këshilli duhet të jetë i kujdesshëm në përllogaritjen e kohës që do të ketë nevojë për përmbylljen e një procedure në mënyrë të tillë që përcaktimi i një afati procedural të respektohet pa ripërtëritje.
- Përsa i përket caktimit të përkohshëm të prokurorëve, rekomandohet ndërprerja e kësaj praktike, dhe miratimi sa më parë i Rregullores për lëvizjet paralele dhe ngritjen në detyrë. Në këtë kontekst, me qëllim trajtimin e barabartë të gjithë prokurorëve, rekomandohet që me miratimin e rregullores përkatëse të rishikohen të gjitha emërimet e bëra deri tani nga Këshilli dhe të zbatohen të njëjtat parime dhe kritere për të gjithë prokurorët, në kushte të njëjta. Përsëri, rekomandohet që për vendet vakante apo për emërimet përfundimtare të prokurorëve, Këshilli të hapë garë dhe të mundësojë konkurrencën efektive ndërmjet tyre. Në këtë mënyrë, prokurorët do të jenë më të motivuar për të qenë pjesë e garës dhe do të evitohen emërime të cilat cenojnë besueshmërinë e këtij institucioni.
- Me qëllim forcimin e transparencës së KLP-së rekomandohet që në faqen zyrtare të KLP-së të publikohen edhe projekt-rregulloret, dhe jo vetëm rregulloret e miratuara në versionin e tyre përfundimtar. Gjithashtu, rekomandohet që argumentet kundër të anëtarëve të Këshillit në një vendimmarrje të caktuar të publikohen bashkë me vendimin përfundimtar.

RAPORT PËRFUNDIMTAR MBI MONITORIMIN E KED

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, ka si detyrë verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kritereve profesionale e morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. E krijuar që në vitin 2017, KED ka funksionuar si organ kolegjial vetëm në vitin 2019. KED e vitit 2017 nuk zhvilloi asnjë aktivitet, ndërkohë që KED i vitit 2018 u mblodh vetëm një herë dhe më tej pezulloi aktivitetin e tij.

Në bazë të parashikimeve ligjore, KED përbëhet prej 9 anëtarësh të përzgjedhur me short, nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilët plotësojnë kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 221/1, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", me një mandat një vjeçar, që fillon në datën 1 Janar të çdo viti kalendarik. Nga procesi i zgjedhjes së anëtarëve të KED (e Përkohshme) e vitit 2019 rezultoi se kjo KED përbëhet jo nga 9, sikurse parashikohet në ligj, por nga 8 anëtarë, një më pak nga numri i parashikuar në Kushtetutë, së bashku me 3 zëvendës anëtarë, kjo për shkak të mungesës së kandidatëve që plotësonin kushtet e zgjedhshmërisë.

Anëtarët dhe zëvendës anëtarët e KED-së 2019 u parashikuan në listën prioritare të subjekteve që do ti nënshtroheshin procesit të vettingut pranë KPK-së, proces ky i cili nuk përfundoi për të gjithë anëtarët e KED, duke qenë se një pjesë e tyre ende nuk e kanë përfunduar këtë proces. Kjo vonesë në vlerësimin e kandidatëve luan një rol të rëndësishëm pasi ndonëse numri i anëtarëve të KED është parashikuar në 9, si rezultat i mos-konfirmimit në detyrë të disa prej tyre, ky numër u reduktua në 6 anëtarë në dhjetor të vitit 2019.[28] Nisur nga ky fakt, është e domosdoshme që kandidaturat të cilat paraqesin kërkesën për të qenë anëtarë të KED-së, si fillim duhet të kenë kaluar procesin e vettingut, pa penguar në këtë mënyrë vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e këtij organi kolegjial. Zvarritja e vlerësimit të kandidatëve të parashikuar në këto lista prioritare mund të mënjanohet duke parashikuar sanksione ndaj palëve të cilat ngadalësojnë këtë proces dhe zvogëlojnë besimin dhe seriozitetin e vetë institucionit.

Duke u përballur me një sërë sfidash dhe vështirësish, KED (e përkohshme) e vitit 2019, me përpjekjen e vet maksimale, ka arritur rezultate mjaft të larta, krahasuar kjo me KED paraardhëse. Pas përfundimit të vitit kalendarik dhe funksioneve të saj, në 5 Dhjetor 2019, Presidenti i Republikës, duke plotësuar detyrimet kushtetuese dhe ligjore, zhvilloi shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për vitin 2020, anëtarë të cilët do të ushtrojnë detyrat e tyre nga 1 janari deri në 31 dhjetor 2020. KED e krijuar për vitin 2020 përbëhet nga 9

[28] *Në datë 17.12.2018, Komisioni i Posaçëm i Apelimit, vendosi shkarkimin nga detyra të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, Z. Bashkim Dedja, ndërsa në 10.12.2019, Komisioni i Pavarur i Kualifikimeve vendosi shkarkimin nga detyra të gjyqtarit Z. Fatri Islamaj.*

anëtarë dhe 4 anëtarë zëvendësues[29]. Jo të gjithë anëtarët e KED-së 2020 e kanë kaluar procesin e vettingut, ashtu sikurse anëtarët e KED 2019.
KPK nuk ka dalë në një vendim për një anëtare, ndërsa 4 anëtarë të tjerë ende nuk i janë nënshtruar këtij procesi.[30] Për të mos hasur probleme dhe vështirësi në vendimmarrje, për shkak të pakësimit të numrit të anëtarëve, është shumë e rëndësishme që procesi i vettingu të realizohet shumë shpejt dhe me përparësi.
Mungesa e kandidatëve nga Gjykata e Lartë, ka bërë të mundur që edhe për vitin 2020, kryetari të jetë përsëri i njëjtë. Por, ndonëse mungesa e kandidatëve nga Gjykata e Lartë është e justifikuar, fakti që si përfaqësues nga Gjykata Kushtetuese është zgjedhur pikërisht i njëjti zëvendëskryetar ngre dyshime. Parashikimi ligjor i mandatit 1 vjeçar nuk është respektuar dhe ky detyrim ligjor mund të zbatohet duke përjashtuar nga lista e kandidatëve të vitit pasardhës, anëtarët aktualë (përsa kohë është e mundur plotësimi i listave me gjyqtarët e emëruar së fundmi).

1. NUMRI I MBLEDHJEVE NË SHTRIRJE KOHORE

KED (e Përkohshme) e vitit 2019 ka zhvilluar mbledhjen e saj të parë në datën 15 Janar 2019. Monitorimi i mbledhjeve të KED është kryer nga marsi i 2019 dhe nga ky muaj deri në mars të vitit 2020 KED në ushtrimin e kompetencave të saj kolegjiale, ka zhvilluar në vitin 2019, **39** mbledhje të cilat janë zhvilluar me dyer të mbyllura, në zbatim të nenit 233/1 të ligjit nr. 115/2016 i cili parashikon se "mbledhjet e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi janë të mbyllura". Ndërsa nga janari i vitit 2020, KED ka zhvilluar 4 mbledhje. Në bazë të të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, Këshilli ka zhvilluar mbledhje në total 102 orë e 3 minuta ose mesatarisht 2 orë e 37 minuta për secilën mbledhje.[31]

Mbledhja e parë e datës 15 janar ka shënuar të vetmin rast kur procesverbali i saj ka qenë shumë i detajuar, diskutimet dhe problematikat janë bërë të gjitha prezent dhe vetë procesverbali është bërë i aksesueshëm për publikun. Më pas, e vetmja mënyrë marrje dijeni ka qenë nëpërmjet njoftimeve tepër të shkurtra të bëra publike në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë. Mospublikimi i procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit është e lidhur ngushtë me faktin që KED ka qenë e detyruar të përdorë burimet njerëzore dhe mjetet financiare në dispozicion të Gjykatës së Lartë, duke mos pasur vetë një organikë.

[29] *Anëtarët Zëvendësues të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të zgjedhur me short më datë 5 dhjetor kanë qenë 5, por numri i tyre u reduktua në 4 pasi në shkurt të vitit 2020, gjyqtarja Marjana Velçni u shkarkua nga KPK.*
[30] Nga anëtarët e KED-së të cilët nuk i janë nënshtruar ende procesit të vettingut, 3 janë anëtarë zëvendësues, ndërsa 1 është anëtar nga gjykata administrative.
[31] *Sipas Raportit vjetor të vitit 2019.*

Duke qenë se sfida parësore për KED-në e 2019 ka qenë miratimi i të gjitha akteve nënligjore që duhet të mundësonin funksionimin sa më të mirë të saj, kjo mund të ketë vështirësuar dhe vonuar nxjerrjen në kohë dhe bërjen publike të procesverbaleve vendimmarrëse. Bie në sy që KED e 2019 i dha përparësi dhe prioritet më tepër procesit, sesa transparencës me publikun.

Pamjaftueshmëria e personelit mbështetës, mungesa e ambienteve të përshtatshme, e bazës financiare dhe ngarkesa tepër e madhe në verifikimin dhe kontrollin e dokumentacionit të kandidatëve nuk ka favorizuar bërjen publike të këtyre procesverbaleve, duke i dhënë përparësi elementit kohë në nxjerrjen e rezultateve. Mungesa e transparencës, në bërjen publike të procesverbaleve të mbledhjeve për gati 1 vit është e justifikueshme nga mungesa e burimeve njerëzore të cilët do të mundësonin përmbylljen në kohë të procesit të transkriptimit, dëgjimit dhe përgatitjes së procesverbaleve të përmbledhur të mbledhjeve të Këshillit. Fakti që dhe vetë Kushtetuta e ka parashikuar KED si një organ me kohë të pjesshmë, pa buxhet, infrastukturë dhe personel të vetin justifikon deri diku mosplotësimin në kohë të këtij detyrimi ligjor në mënyrën dhe kohën e duhur.

Në fund të vitit si rezultat dhe i presionit publik të bërë nga aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile, në faqen zyrtare të Këshillit, janë bërë publike të gjitha procesverbalet e mbledhjeve të realizuara nga ana e KED, procesverbale këto të detajuara në të njëjtën mënyrë sikurse procesverbali i mbledhjes së parë. Janë marrë të gjitha masat duke i dhënë një zgjidhje teknike dhe administrative për të mos vonuar procesin e publikimit të procesverbaleve dhe tashmë në faqen zyrtare të KED mund të aksesohen lehtësisht dhe të mund të merret dijeni në lidhje me këto procesverbale, duke u zgjidhur në këtë mënyrë dhe problemi i transparencës me publikun.

Nga faqja zyrtare të internetit konstatohet se mbledhjet e zhvilluara nga KED kanë qenë të shumta (në veçanti gjatë muajit korrik dhe gusht) dhe me ngarkesë të madhe të cilat për shkak të kësaj ngarkese vendimet e marra në lidhje me lejimin ose ndalimin e kandidatëve janë bërë publike brenda pak ditësh. Ajo që bie në sy, në raportimet e mbledhjeve është fakti që gjatë gjithë mbledhjeve kanë qenë të pranishëm përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, përfaqësuesi i Presidentit të Republikës dhe subjektet e tjera të ftuara sipas ligjit. Sipas materialeve të vëna në dispozicion në faqen zyrtare të internetit këta persona kanë qenë aktivë gjatë zhvillimit të mbledhjeve nëpërmjet diskutimeve të tyre, duke shprehur mendime, qëndrime dhe sugjerime të vlefshme për Këshillin.

Por, në vitin 2020, pavarësisht se numri i mbledhjeve të zhvilluara ka qenë i vogël (në total 4)mungon publikimi i procesverbaleve, me përjashtim të atij të datës 15 janar 2020, i cili korrespondon me mbledhjen e parë të KED për këtë vit. Përsëritet në këtë mënyrë e njëjta situatë me atë të vitit 2019, ku i vetmi procesverbal i bërë publik ka qenë ai i mbledhjes së parë, duke publikuar të gjitha procesverbalet e tjera vetëm në fund të vitit 2019, duke munguar në këtë

mënyrë transparenca në lidhje me pjesëmarrjen dhe diskutimet e zhvilluara nga anëtarët e pranishëm dhe organet e tjera përfaqësuese në këto mbledhje.

2. PROCEDURA E KRYERJES SË NJOFTIMIT PËR ÇDO MBLEDHJE. PUBLIKIMI I VENDIMEVE

Në bazë të parashikimeve të ligjit nr. 115/2016 në nenin 233, pika 3 i cili i referohet transparencës së KED Parashikohet shprehimisht se: Këshilli komunikon me publikun pas çdo mbledhjeje përmes një komunikate për mediat, e cila informon së paku për: a) kohën e mbledhjes; b) pjesëmarrjen; c) kandidatët, jetëshkrimin e përditësuar të tyre, pozicionet për të cilat ata kandidojnë dhe institucionet propozuese; ç) një shpjegim të shkurtër të procedurave dhe të metodës së ndjekur për verifikimin kushteve ligjore dhe të kritereve të përdorura për renditjen e kandidatëve; d) aktin përfundimtar të verifikimit dhe renditjes së kandidatëve.

Njoftimi i kryerjes së mbledhjeve ka qenë një procedurë e cila nuk është respektuar sikurse duhet. Në fillimet e saj, KED nuk e ka pasur si praktikë të saj procedurën e njoftimit të mbledhjeve. Lajmërimi për mbledhjen e radhës ishte i menjëhershëm dhe shpeshherë i brendshëm, pa shpallje në faqen zyrtare të internetit, duke vështirësuar marrjen dijeni. Disa prej këtyre mbledhjeve janë anuluar dhe shkaku i anulimit të tyre nuk është bërë transparent për publikun.

Nga data 14.05.2019 KED ka nisur njoftimin paraprak të mbledhjeve të ardhshme, por pavarësisht kësaj vërehen dhe mbledhje të cilat janë mbajtur pa u dhënë njoftimi paraprak në faqen e internetit, për ditën, orën dhe çështjet që ishin në rend të ditës. Me ristrukturimin e faqes së internetit dhe përditësimin e saj, ndryshoi dhe mënyra e njoftimeve. Evidentohet një korrektësi në mënyrën e njoftimit të mbledhjeve, e cila ka vazhduar dhe është ndjekur edhe nga KED e 2020. Si praktikë e cila është ndeshur më shpesh është njoftimi paraprak në faqen e internetit 24 orë para zhvillimit të mbledhjes, njoftim i cili zakonisht përmban ditën e mbledhjes, orën e mbledhjes si dhe rendin e ditës.

Informacioni që ka ofruar faqja e internetit në muajt e parë të funksionimit të KED 2019 ka qenë shumë i kufizuar, ashtu sikurse mund të thuhet që për një kohë të gjatë KED nuk ka pasur një e-mail zyrtar ose një adresë të saktë. Në lidhje me pjesëmarrjen e anëtarëve në mbledhje, Këshilli në procesverbalet e bëra publike vazhdon të mos paraqesë (pavarësisht sugjerimeve nga aktorë të jashtëm) se sa anëtarë dhe cilët kanë qenë të pranishëm, nëse ka pasur diskutime apo kundërshtime, cili prej tyre është aktivizuar dhe ka diskutuar, cila ka qenë procedura e votimit, kush ka qenë pro dhe kush kundër. Gjithashtu,vihet re mungesë e plotë informacioni nëse ka pasur vendim pakice apo nëse të gjitha vendimet kanë qenë unanime.

Ndërsa në lidhje me KED të 2020, të gjitha mbledhjet e mbajtura nga ky Këshill janë njoftuar paraprakisht së bashku me orën, rendin e ditës, si dhe evidentohen edhe palët pjesëmarrëse në mbledhje. Theksohet fakti se, pavarësisht se gjatë muajit shkurt janë miratuar 4 projektvendime nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, këto projektvendime, edhe pse ka kaluar kohë e konsiderueshme (45 ditë) ende nuk janë bërë publike në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, duke mos u evidentuar këto ndryshime, por e vetmja mënyrë për të marrë dijeni për to është Fletorja Zyrtare.

Fakti që me të njëjtat burime duhet të realizohet njëkohësisht edhe mbështetja e veprimtarisë së KED edhe veprimtaria e GJL e mbingarkuar nga numri i dosjeve gjyqësore në pritje për shqyrtim, kushtëzon realizimin në kohë sa më të shpejtë të bërjes publike dhe informimit për publikun.

Një risi e cila është vlerësuar pozitivisht është përgatitja e programit të transparencës për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, kjo në përputhje të plotë me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI-së. Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparente veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, nëpërmjet pasqyrimit të detajuar të tij në faqen zyrtare, faqe kjo e cila është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm.

3. NUMRI I VENDIMEVE NË SHTRIRJE KOHORE

Numri i vendimeve të marra nga KED (e përkohshme) e 2019 është gjithsej 154 vendime. Të gjitha vendimet janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit dhe janë të aksesueshme nga të gjithë. Vlen të theksohet fakti që KED është impenjuar në maksimum për t’i zbardhur sa më shpejt vendimet, pavarësisht periudhës kohore tepër të ngjeshur kur janë marrë këto vendime.

Për të rritur transparencën gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, këto vendime janë të arsyetuara në mënyrë të hollësishme në lidhje me të gjitha procedurat e ndjekura nga Këshilli si dhe të shoqëruara me aktet e tjera të lidhura me procesin e kandidimit, vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve.

Për vitin 2020 numri i vendimeve të marra nga KED është vetëm 1, si dhe janë miratuar në muajin shkurt të këtij viti 4 projektvendime në lidhje me disa shtesa dhe ndryshime të vendimit nr. 1,2, 4 , dhe 5 të vitit 2019.

4. VENDIME TË TJERË TË MARRA NGA KED

Gjatë vitit 2019, nga ana e KED janë nxjerrë **10** vendime për rastet e heqjes dorë nga anëtarët e Këshillit ose të kërkesave të kandidatëve për përjashtim të anëtarëve nga procedura e verifikimit dhe e vlerësimit të kandidaturave për shkak papajtueshmërie ose konflikti interesi.

Në zbatim të kompetencave të tij, KED gjithashtu ka nxjerrë 2 urdhra që lidhen me miratimin e rregullave të hollësishme përsa i përket plotësimit të kushteve për pranimin, ruajtjen dhe administrimin e informacioneve të klasifikuara që kanë lidhje me kandidatët.

Në datën 02.04.2019 është miratuar nga Këshilli Akti Normativ mbi vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve për GJK dhe ILD, akt i cili u bë publik vetëm pas 1 muaj nga miratimi. Mungesa e publikimit ndeshet edhe në rastin e hedhjes së shortit për caktimin e relatorëve. Vendimi nr. 2, datë 15.02.2019 në pikën 9 të tij parashikon që dita, ora dhe vendi i zhvillimit të shortit elektronik për caktimin e relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

Gjithashtu, në bazë të nenit 18, të Rregullores së brendshme të KED, në rastin e kryerjes së procedurave të shortit, të verifikimit dhe të vlerësimit të kandidatëve, njoftohen publikisht në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë përveç rezultateve të shortit edhe jetëshkrimet e përditësuar të kandidatëve, jetëshkrime të cilat janë bërë publike vetëm në muajin gusht, pas marrjes së vendimeve se cili prej kandidatëve është ndaluar dhe cili është lejuar.

Në faqen zyrtare të KED janë të publikuara dhe të aksesueshme për publikun listat e kandidatëve të cilët kanë aplikuar për vakancat e krijuara, lista e kandidatëve të tërhequr nga kandidimi, lista e kandidatëve të përjashtuar dhe e atyre të lejuar, jetëshkrimet re tyre, vendimet e Gjykatës Administrative, si dhe pikëzimi i secilit prej kandidatëve të lejuar. Ky fakt vlerësohet pozitivisht dhe shoqërohet më një rritje të besueshmërinë dhe transparencës e cila është kërkuar që në fillim të procesit të plotësimit të vakancave në Gjykatën Kushtetuese. I njëjti model mund të ndiqet edhe nga organet e tjera të drejtësisë, KLGJ dhe KLP, pasi vetëm nëpërmjet publikimit dhe marrjes dijeni nga cilido person i interesuar do bëhet e mundur rritja e besueshmërisë në funksionimin sa më të drejtë dhe transparent të të gjitha organeve të krijuara.

Nëse i referohemi procedurës së hedhjes së shortit për caktimin e relatorëve për pozicionet vakante është diskutuar së shumti nëse është respektuar apo jo afati kohor i përcaktuar në vendimin nr. 2, datë 15.02.2019. Në pikën 5 të këtij vendimi parashikohet se: "*dita dhe ora e zhvillimit të procedurës së shortit elektronik për caktimin e relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion caktohet jo më vonë se 5 ditë nga dita e publikimit të listës së kandidatëve (21.03.2019) për*

pozicionin vakant në Gjykatën Kushtetuese nga subjektet që vënë në lëvizje Këshillin e Emërimeve në Drejtësi ose nga ajo e publikimit të listës së kandidatëve për pozicionin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nga ana e këtij Këshilli." Shorti i parashikuar nga vendimi i cituar në lidhje me relatorin e pozicionit vakant është hedhur vetëm në datën 5 prill 2019 duke u pretenduar në këtë mënyrë një shkelje e afatit 5 ditor të caktuara nga vetë KED. Por, nëse ju referohemi Dispozitave Kalimtare dhe të Fundit shohim një përjashtim për sa i përket vitit 2019.

Caktimi i relatorëve për pozicionet vakante, për shkak të pamundësisë teknike të realizimit të shortit në rrugë elektronike, pamundësi kjo e justifikuar edhe me një raport teknik me shkrim, u krye në fomën manuale, me praninë e anëtarëve të KED, Avokates së Popullit dhe përfaqësuesve të subjekteve të ftuar sipas ligjit, duke respektuar parimin e transparencës, gjurmueshmërisë dhe monitorimit të procesit.[32]

Në pikën 41 të këtij vendimi parashikohet se: procedurat e shortit për caktimin e relatorëve për pozicionet vakante ekzistuese të shpallura nga çdo institucion që ka vënë në lëvizje Këshillin, do të zhvillohen jo më vonë se 3 ditë nga ajo e miratimit dhe hyrjes në fuqi të akteve nënligjore mbi procedurat e verifikimit të pasurisë, integritetit dhe të së shkuarës profesionale e personale të kandidatëve, si edhe për vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve. Aktet normative mbi vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve për GJK dhe ILD janë miratuara vetëm në datën 02.04.2019, dhe shorti është hedhur në datën 05.04.2019 duke respektuar në këtë mënyrë dispozitat e vendimit nr. 2, datë 15.02.2019.

Një tjetër vendim i marrë nga KED gjatë kësaj periudhe ka qenë vendimi nr. 4, i datës 11.03.2019 *"Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë"*, vendim në të cilin ndeshet koncepti i Dhomës së Këshillimi në mbledhjet e KED, koncept ky i cili jo vetëm nuk është parashikuar në ligj, por gjithashtu është një koncept i cili nuk ndeshet as në procedurat gjyqësore administrative. Në pikën 41 të këtij vendimi parashikohet se: Bisedimet e çështjes, si edhe votimi i vendimit bëhen vetëm me praninë e anëtarëve të Këshillit, duke përjashtuar në këtë mënyrë Avokatin e Popullit si dhe përfaqësuesit e subjekteve të cilët ftohen sipas ligjit. Në lidhje me këtë vendimmarrje të KED, Avokati i Popullit ka ngritur një padi kundër KED në Gjykatën Administrative të Apelit për shkelje të kompetencave të këtij institucioni.

Ky përjashtim mund të sjellë një kufizim të paligjshëm të kompetencave të Avokatit të Popullit, pasi i mohohet e drejta për të marrë dijeni dhe për të mbrojtur interesat e palëve. Gjithashtu, ky fakt ngre pikëpyetje edhe përsa i përket transparencës, marrjes përsipër të përgjegjësisë, si dhe paanshmërisë në marrjen e vendimeve.Përjashtimi i këtyre subjekteve nuk pasqyrohet as në

[32] *Pika 3, neni 228, Ligji nr. 115/2016. Përjashtimisht, në qoftë se sistemi elektronik nuk funksionon, shorti mund të kryhet manualisht. Këshilli miraton rregulla më të detajuara për të bërë të mundur që procedura e shortit për caktimin e relatorit t'u përmbahet parimeve të transparencës, gjurmueshmërisë dhe monitorimit të procesit.*

vendimin e publikuar. Në pjesën hyrëse të vendimit thuhet se cilët subjekte kanë qenë prezent (duke përfshirë në këtë mënyrë edhe Avokatin e Popullit dhe përfaqësuesit e tjerë), thuhen më pas mendimet e dhëna nga gjithsecili pjesëmarrës, por nuk thuhet që në momentin e diskutimeve për problematika të ndryshme apo në momentin e votimit, për shkak të parashikimit të Rregullores nr. 4 të KED, këta subjekte nuk kanë qenë prezent. Kjo mungesë saktësimi e palëve prezent në vendimmarrje shtron tek gjithsecili pikëpyetje duke venë në dyshim transparencën e kërkuar në marrjen e vendimeve.

Nga monitorimet e kryera bie në sy fakti që KED ka përdorur një standard të dyfishtë për sa i përket pjesëmarrjes në mbledhjet e zhvilluara. Vihet re që është e lejueshme dhe mund të marrin pjesë ndërkombëtarët, pjesëmarrje kjo e cila mundësohet edhe nga ligji, ndërsa për sa ju përket organizatave shqiptare, KED ka qenë kategorike në moslejimin edhe në mosmarrjen pjesë të tyre në këto mbledhje.

Fakti që vëzhguesit nuk kanë pasur akses gjatë zhvillimit të veprimtarisë dhe ushtrimit të funksioneve ligjore të KED, ka bërë që monitorimi të jetë deri diku i pjesshëm, pasi ky monitorim fokusohet dhe bazohet vetëm tek dokumentet e vëna në dispozicion nga faqja zyrtare e KED, pa mundësuar pjesëmarrjen fizike të vëzhguesve të tjerë. Transparenca e procesit garantohet në këtë mënyrë vetëm nëpërmjet pranisë nëpër mbledhje të Avokatit të Popullit, duke qenë se gjatë procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve nuk mund të jenë të pranishëm as vetë palët e interesuara, as media dhe as organizatat e shoqërisë civile.

Në bazë të informacioneve të publikuara, gjatë mbledhjeve të KED kanë qenë prezent dhe kanë marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e realizuara përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, përfaqësuesi i Presidentit të Republikës, si dhe përfaqësuesi i Kuvendit, i cili ka marrë pjesë rregullisht deri në mars të 2019, moment ky i cili shënon shpalljen e vendeve vakante për ILD, dhe më pas vetëm në mbledhjet që kanë konsideruar të përshtatshme.

Vihet re se numri i kandidatëve të cilët plotësonin kushtet ligjore për tu zgjedhur anëtarë të Gjykatës Kushtetuese ose kandidatët për ILD ka qenë tepër i ulët, madje në vakancat e Gjykatës Kushtetuese paraqiten të njëjtët emra për vakanca të ndryshme. Ky numër i ulët është tregues i faktit se kriteret e vendosura nga ligji janë të forta dhe burimet njerëzore të interesuara për këto pozicione janë të pamjaftueshme për të garantuar një konkurrencë të lartë midis kandidaturave. Shfaqja e interesit, për vakancat e krijuara, nga të njëjtët persona nuk do të thotë që janë shteruar burimet njerëzore në Shqipëri, por ndërlikimi i procesit të rekrutimit, afatet shumë të shkurtra për të dorëzuar dokumentacionin, si dhe vështirësia për të siguruar gjithë këtë dokumentacion janë refklektuar pikërisht në listat e kandidatëve duke treguar një mungesë besimi në lidhje me gjithë këtë proces.

5. METODOLOGJIA PËR VLËRËSIMIN DHE CAKTIMIN E PIKËVE PËR RENDITJEN E KANDIDATËVE PËR GJYQTAR NË GJK DHE ILD.

Duke ju referuar metodologjisë të miratuar nga Këshilli vërejmë se KED ka vlerësuar se kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe të renditjes së kandidatëve për GJK që do merren parasysh do të klasifikohen në tre kategori:

a) Meritat profesionale; 60 pikë
b) Meritat morale; 30 pikë
c) Meritat organizative, drejtuese dhe menaxhuese. 10 pikë.

Ndërsa për sa i përket kandidatëve për ILD Vërehet nga shpërndarje tjetër e pikëve, duke bërë të mundur vlerësimin e kritereve në mënyra të ndryshme.

a) Meritat profesionale; 50 pikë
b) Meritat morale; 25 pikë
c) Meritat organizative, drejtuese dhe menaxhuese. 25 pikë.

Vlen të theksohet fakti se përveç rëndësisë të justifikuar të meritave profesionale (duke qenë se qëllimi i KED ka qenë pikërisht zgjedhja e kandidatëve më të mirë) një peshë e konsiderueshëm në pikë i është dhënë edhe vlerësimit të meritave morale. Profesionalizmi dhe integriteti moral i Gjyqtarit janë kriteret më të rëndësishme dhe thelbësore të vetë Reformës në Drejtësi, prandaj dhe pikëzimi i këtyre cilësive është mëse i justifikuar. Por, duhet theksuar fakti se për të arritur një vlerësim sa më të drejtë dhe të paanshëm, një ndër sfidat e Këshillit ka qenë pikërisht gjetja e burimeve të besueshme të cilat do të vlerësojnë në mënyrën e duhur moralin dhe integritetin e kandidatëve. Shqyrtimi dhe gjykimi i integritetit të kandidaturave nga KED, sipas standardeve të parashikuara, ka qenë një procedurë tepër e vështirë për shkak të mangësive nga ana funksionale, si dhe mjeteve ligjore dhe kapaciteteve njerëzore krahasuar kjo me kapacitetet e vënë në dispozicion organeve të tjera të rivlerësimit kalimtar. Por, nëse i njëjtit pikëzim i jepet si integritetit etik dhe moral, ashtu edhe historikut arsimor kjo mund të bëjë të mundur që të mos i jepet rëndësia e duhur përgatitjes profesionale të kandidatëve (eksperienca arsimore, kualifikimet pasuniversitare, vjetërsia në profesion), kur realisht ajo për të cilën ka nevojë sistemi i drejtësisë është pasja e një gjyqësori profesionist dhe të përgatitur, gjithmonë etik dhe të moralshëm.

Vlen të theksohet është fakti që KED, për kontrollin e kandidaturave për në Gjykatën Kushtetuese, ka përdorur një filtër shumë të imët, duke evituar në këtë mënyrë gjetjet që mund të verifikohen më pas, të cilat do të çonin në tërheqjen e kandidatëve dhe në lënien e vendit bosh nga ana e tyre. Ky verifikim pavarësisht se do të mundësonte plotësimin e vakancave në mënyrë përfundimtare dhe krijimin e organeve të qëndrueshme të drejtësisë dha fryte të ndryshme nga pritshmëria. Vetë

shkarkimi i Z. Besnik Muçi, si gjyqtar i GJK nga ana e Komisionit të Posaçëm të Apelimit, ka cenuar besimin e publikut duke dyshuar në thellësinë e hetimit të kandidaturave në krahasim e organet e tjera të rivlerësimit kalimtar, pavarësisht seriozitetit të KED për të bërë një vlerësim sa më serioz dhe sa më profesional. Prandaj është e rekomandueshme që kandidaturat që do të përfshihen në listat e KED të kenë përfunduar fillimisht procesin e vettingut, pasi kjo do të shmangte vënien në lëvizje të institucioneve të emërtesës si dhe cënimin e besimit të publikut në një rast shkarkimi të mëvonshëm të kësaj kandidature nga organet e vettingut.

Gjithashtu, vlen të theksohet se ndaj kandidatëve për GJK dhe ILD është përdorur një procedurë e diskutueshme nga publiku për sa i përket verifikimit të pasurisë, verifikim ky i bërë në varësi të faktit nëse këta kandidatë gëzojnë statusin magjistrat apo jo. Kandidatët magjistratë po përballen prej kohësh me procesin e vettingut, proces i cili kalon në filtra shumë të imët, gjë e cila nuk ndodh me kandidatët jo magjistratë të cilët nuk i janë nënshtruar procesit të vettingut, por procesi i verifikimit është realizuar nga KED me ndihmën e ILDKPKI-së. Ndryshe nga kandidatët magjistratë (procesi i verifikimit i të cilëve ka zgjatur për muaj të tërë) për kandidatët e tjerë verifikimi është kryer në një periudhë kohore shumë të shkurtër, duke u referuar tek raportet e ILDKPKI-së, një institucion me burime të limituara krahasuar me strukturat e vettingut. Prandaj do të ishte e udhës që të merreshin masa për të përcaktuar rregulla më të hollësishme dhe konkrete mbi procedurat dhe kompetencat e KED sa më të përafërta me ato të organeve të rivlerësimit kalimtar.

Duke ju referuar të dhënave të publikuara nga vendimet e marra nga KED rezulton se: Në momentin kur KED ka filluar zyrtarisht procedurën e verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për vakancat e shpallura, kanë kandiduar 48 kandidatë për Gjykatë Kushtetuese dhe 12 kandidatë për ILD, duke bërë kështu që numri në total i kandidatëve që do merreshin në shqyrtim të shkonte në 60.

Janë marrë 30 vendime në lidhje me 20 kandidatë të tërhequr nga gara (GJK dhe ILD) si dhe 14 vendime mbi 7 kandidatë të ndaluar nga kandidimi (GJK). Disa prej tyre janë tërhequr pikërisht për shkak të pamundësisë së dorëzimit të dokumentacionit; disa të tjerë nuk i kanë treguar shkaqet e tërheqjes nga kandidimi.

Sipas të dhënave të publikuara në faqen zyrtare rezulton se 9 prej kandidatëve të ndaluar i janë drejtuar Gjykatës Administrative, e cila ka rrëzuar të gjitha pretendimet si të pambshtetura në ligj dhe në prova, me përjashtim të dy padive të kandidates së ndaluar Zhaklina Peto ku disponoi shfuqizimin e vednimeve të Këshillit. KED rishqyrtoi të dyja rastet e kandidimit të kandidates për Gjykatë Kushtetuese duke arritur përsëri tek të njëjtat përfundime me vendimet e mëparshme në lidhje me po këtë kandidate duke vendosur përsëri ndalimin për mosplotësim të kushteve ligjore.

Rezultatet e pikëzimit si dhe renditja në pikë për secilin prej kandidatëve dhe për secilën vakancë në Gjykatën Kushtetuese, u bë menjëherë publike në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë duke

mundësuar në këtë mënyrë marrjen dijeni nga çdo person i interesuar. Listat përfundimtare të renditjes së kandidatëve ju janë dërguar gjithashtu edhe organeve të emërtesës (Presidentit të Republikës dhe Kuvendit) për të ushtruar të drejtën e emërimit dhe të zgjedhjes. Presidenti i Republikës e ushtroi të drejtën e tij brenda 7 ditëve nga dërgimi i listës përfundimtare, Dy ditë para përfundimit të afatit 30 ditor të ushtrimit ose jo të së drejtës së tij për të emëruar Gjyqtarin e GJK nga tre të parët në listë, Presidenti pezullon procesin e tij të ushtrimit të së drejtës për emërimin e gjyqtarit në GJK, derisa Kuvendi të ushtrojë të drejtën e tij për të emëruar.

Me sistemin e ri të përzgjedhjes së kandidatëve, u mendua se krijimi i Gjykatës Kushtetuese nuk mund të pengohet nga aktorët politikë. Presidenti dhe Parlamenti nuk duhet të binin dakord për emërimet, duke qenë se emërimi ka për të kaluar me rotacion nga Presidenti, Parlamenti dhe Gjykata e Lartë, duke mundësuar dhe siguruar që gjyqtarët e zgjedhur të jenë më të kualifikuarit duke mos u përqendruar në këtë mënyrë përzgjedhja e tyre në një kompromis midis forcave politike. Por, faktet treguan se ndërmjet dy institucioneve, Presidentit te Republikës dhe Kuvendit u krijua një ngërç institucional në lidhje me 2 kandidate të emëruara në Gjykatën Kushtetuese, ngërç ky i krijuar si rezultat i mungesës së dialogut dhe vullnetit për gjetjen e zgjidhjes nga Presidenti, Kuvendi dhe KED.
Krijimi i ngërçit institucional për mosrespektimin nga ana e KED-së të radhës kronologjike, përsa i takon plotësimit të vendeve vakante në GJK, të shpallura nga Presidenti dhe Kuvendi ka sjellë një situatë jo të zakonshme për reformën e re në sistemin e drejtësisë dhe objektivat që ajo synon.
Dërgimi i listave nga ana e KED në afate të ndryshme kohore Presidentit dhe Kuvendit është konsideruar si një ndër shkaqet kryesore të krijimit të konfliktit.

Ky konflikt ndërinstitucional i krijuar ndërmjet Presidentit, Kuvendit dhe KED ka ndikuar dukshëm në besimin e profesionistëve të cilët mund të bëhen pjesë e proceseve të tilla, shoqëruar kjo dhe me zvogëlimin e interesit për të kandiduar. Duke u nisur nga kjo situata është e nevojshme mirëkuptimi ndërmjet palëve dhe gjetja e një zgjidhjeje të përbashkët me dialog dhe mirëkuptim.

Zvogëlimi i interesit për të kandiduar por edhe rregullat tepër të rrepta, shoqëruar më afatet shumë të shkurtra për plotësimin dhe dorëzimin e dokumentacionit, u shoqërua me dërgimin e 4 listave me 6 emra të njëjtë nga ana e KED. Ky fakt nuk do të thotë që në Shqipëri mungojnë burrimet njerëzore të kualifikuara, pasi personalitetet në fushën juridike janë të shumtë dhe nga më të spikaturit, por ende është herët për të forcuar bindjen që realisht Reforma po funksionon dhe krijimi i GjK është shumë afër bërjes realitet. Prandaj, zgjidhja sa më shpejt e konfliktit ndërinstitucional dhe vënia në lëvizje e gjithë sistemit të drejtësisë ndoshta do të shtojë në të ardhmen interesin dhe mundësinë për tu bërë pjesë e këtij sistemi.

Drejtimi i këtyre institucioneve tek Komisioni i Venecias, për të kërkuar opinion mbi procesin e emërimit në Gjykatën Kushtetuese, si nga ana e Presidentit të Republikës, ashtu edhe nga ana e Kuvendit evidenton një mbipërdorim të këtij Komisioni, të cilit shpesh palët i drejtohen sa herë mungon bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet tyre. Kjo përplasje institucionale e krijuar gjatë procesit të ngritjes dhe funksionimit të Gjykatës Kushtetuese nëse do të vazhdojë është duke

dobësuar së tepërmi punën mjaft të madhe të të gjitha institucioneve shtetërore në angazhuar në Reformën në Drejtësi.

Për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë fillimisht kanë kandiduar 12 kandidatë ndër të cilët

- Janë tërhequr nga Kandidimi 4 Kandidatë:
- Janë ndaluar nga Kandidimi 4 kandidatë:
- Janë lejuar nga Kandidimi 4 Kandidatë.

Duke qenë se në garë për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë (ILD) ngelën vetëm 4 kandidatë, nga 5 të tillë që përcakton Kushtetuta[33], Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED) në datë 09.09.2019 rishpall thirrjen për shprehje interesi për kandidime të tjera, në plotësim të atyre 4 kandidatëve tashmë të lejuar me vendim nga Këshilli. Në këtë mënyrë numri i kandidatëve të cilët shprehën interesin për ILD shkoi në 8, duke mundësuar në këtë mënyrë zgjedhjen e Inspektorit, zgjedhje e cila u shoqërua me emërimin dhe fillimin e detyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në janar 2020.

Duke marrë në konsideratë vështirësitë, sfidat me të cilat duhet të përballej për herë të parë KED si dhe pamjaftueshmëria e burimeve materiale, financiare dhe njerëzore, arritja e rezultateve të pritura brenda vitit ka qenë pothuajse e pamundur, pavarësisht prioriteteve për krijimin dhe funksionimin sa më parë në kohë të Gjykatës Kushtetuese dhe ILD. KED –së i ka rënë një barrë e jashtëzakonshme për të verifikuar dhe vlerësuar lista me kandidatë për shumë vakanca njëkohësisht, punë kjo e cila është realizuar nën presionin e jashtëzakonshëm të publikut, për vetë faktin që vendit i ka munguar prej kohësh një Gjykatë Kushtetuese funksionale.

Për një funksionim sa më të mirë të KED të 2020, duke u bazuar edhe tek eksperienca e KED paraardhëse, shtimi i kapaciteteve njerëzore asistuese të angazhuar pranë këtij këshilli do të mundësonte një përmbushje sa më të plotë të të gjitha detyrimeve dhe parashikimeve ligjore, si për sa i përket publikimit të materiale të mbledhjeve, të procesverbaleve, akteve normative, etj, si dhe plotësimi i të gjitha vakancave në Gjykatën Kushtetuese, duke përmbushur në këtë mënyrë vetë funksionin dhe qëllimin për të cilin është parashikuar dhe krijuar ky Këshill.

[33] *Neni 147/d i Kushtetutës përcakton se: "Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet nga lista e pesë kandidatëve të përzgjedhur dhe renditur mbi bazën e meritave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas një procedure transparente dhe publike."*

MONITORIMI I VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË PAVARUR PËR KOORDINIMIN, MONITORIMIN DHE NDJEKJEN E ZBATIMIT TË LIGJIT PËR ORGANET E QEVERISJES TË SISTEMIT TË DREJTËSISË

Kuvendi i Shqipërisë miratoi me vendimin Nr. 74/2018 ngritjen e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit Nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" *(Komisioni Pavarur),* i cili u konstitua në mbledhjen e tij të parë në datë 05.11.2018. Komisioni, përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët në mbledhjen e tyre të parë zgjodhën kryetarin dhe sekretaren e tij. Anëtarët u votuan nga Kuvendi i Shqipërisë pas një procedure përzgjedhje që ndoqi paraprakisht Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut[34].

Komisioni i Pavarur ka detyrë[35] të monitorojë proceset e përzgjedhjes së kandidatëve dhe të zgjedhjes dhe emërimit të anëtarëve të organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, si dhe të bëjë koordinimin midis institucioneve dhe organeve që zbatojnë ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë". Po ashtu, ky organ ndjek ecurinë e zbatimit të parashikimeve të ligjit nr. 115/2016 nga institucionet e sistemit të drejtësisë dhe raporton një herë në muaj në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe në seancë plenare të Kuvendit sa herë e shikon të nevojshme.

Komisioni i Pavarur ka detyrim ligjor të evidentojë rastet kur institucionet përgjegjëse nuk zbatojnë ligjin brenda afatit dhe nuk kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj, lidhur me çështjet e mësipërme, duke ia bërë me dije Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, ose drejtpërdrejt Kuvendit, përfshirë dhe propozimin për marrjen e masave përkatëse për moszbatimin e ligjit. Institucionet e sistemit të drejtësisë që hyjnë në kompetencat monitoruese të Komisionit të Pavarur janë Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

Komisioni i Pavarur e zhvillon aktivitetin e tij pranë selisë së Kuvendit të Shqipërisë dhe asistohet në punën e tij nga administrata e Kuvendit, e cila ka krijuar një sekretariat teknik të posaçëm të përbërë nga 3 nëpunës të Kuvendit, 2 Këshilltar dhe 1 Sekretare. Mbledhjet e këtij organi zhvillohen

[34] *Vendimi 97/2018 Miratuar në datën 20.9.2018 dhe Vendimi 109/2018 Miratuar ne datën 20.10.2018 nga Kuvendi i Shqipërisë*
[35] *Neni 288 e vijim i Ligjit Nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" dhe Vendimi 74/2018 të Kuvendit të Shqipërisë*

me dyer të mbyllura dhe nuk janë lejuar të ndiqen nga monitorues të jashtëm, përfshirë këtu edhe shoqërinë civile.

Komisioni i Pavarur, ka krijuar një rubrikë të veçantë informative online, brenda faqes zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë, me anë të së cilës prezanton periodikisht të dhëna mbi punën e tij. Kjo rubrikë ka mungesë në të dhënat mbi anëtarët e Komisionit të Pavarur, zhvillimin e mbledhjeve dhe tematikat e tyre, procesverbalet e mbledhjeve, dokumente mbi programin e transparencës ndaj publikut, regjistrin elektronik të kërkesave për të drejtën e informimit, datat e raporteve të skanuara në faqe etj.

Komisioni i Pavarur ka miratuar një rregullore mbi organizimin dhe zhvillimin e veprimtarisë së tij[36], kryesisht për zhvillimin e mbledhjeve, administrimin e dokumentacionit dhe seancat publike dëgjimore. Nga monitorimi i zhvilluar, nuk është evidentuar ndonjë rregullore tjetër e veçantë e miratuar mbi rregullat e etikës dhe marrëdhëniet me publikun. Komisioni ka një mungesë të vazhdueshme të publikimit zyrtar të njoftimeve periodike mbi aktivitetin e tij në marrëdhënie me organet e tjera, deklarata për shtyp apo qëndrime për situata të ndryshme në organet e drejtësisë. Ai komunikon me publikun, duke publikuar vetëm raportet dhe rekomandimet periodike drejtuar organeve të drejtësisë.

Komisioni i Pavarur, ka miratuar[37] në mënyrë unanime 11 raporte periodike, nga të cilat 2 janë përmbledhje mbi veprimtarinë e tij, ndërsa 9 janë mbi tematika të veçanta të procedurave të ndjekura nga organet e drejtësisë, gjatë përzgjedhjes së kandidatëve në organet respektive. Në raportet e publikuara për periudhën Nëntor 2018-Maj 2019, Komisioni i Pavarur ka adresuar 31 rekomandime ndaj Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Raportet së bashku më rekomandimet përkatse, i janë drejtuar njëkohësisht edhe Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit.

Nga 31 rekomandime të adresuara, Komisioni Pavarur[38] nuk ka marrë informacion për 12 prej tyre, të lidhura këto me trajtimin e tyre nga organet përkatëse. Ndërkohë që për 6 rekomandime të tjera, Komisioni Pavarur ka konstatuar moszbatimin e tyre, e njohur kjo me anë të qëndrimeve zyrtare nga organet respektive të drejtësisë. Për 13 rekomandimet e tjera, Komisioni i Pavarur ka informacion që ato janë pranuar plotësisht ose pjesërisht. Referuar numrit të lartë të rekomandimeve pa përgjigje, vërehet se veprimtaria koordinuese e Komisionit të Pavarur, si detyrë integrale që buron nga ligji dhe vendimet e Kuvendit, nuk është zbatuar në nivelin e duhur. Madje në raportet e Komisionit të Pavarur evidentohet më tepër puna raportuese në nivel konstatues, sesa ndjekja deri në fund e rekomandimeve *"folloë up"* me qëllim zgjidhjen e problematikave të adresuara.

[36] *Vendimi Nr.3 dt. 09.11.2018 të KPMKN*
[37] *Raport i publikuar i KKMN për periudhën Nëntor 2018-Maj 2019*
[38] *Raport Periiodik Nentor 2018- Maj 2019 KKMN*

Pas periudhës së mësipërme të raportimit, Komisioni i Pavarur nuk ka publikuar një raport të ri përmbledhës për punën e tij[39], duke mos treguar transparencë mbi rezymenë e punës, problematikat e hasura dhe veçanërisht mbi reagimet e organeve përkatëse në përgjigje të rekomandimeve të tij. Kjo do të shërbente për të matur edhe efiçencën në vijueshmëri të punës së Komisionit të Pavarur.

Periudha Maj 2019 deri Shkurt 2020 shkon përtej afatit 6 mujor të vendosur si praktike për raportim periodik të punës nga Komisioni i Pavarur. Megjithatë për këtë periudhë, Komisioni i Pavarur ka miratuar 7 raporte të shoqëruara me 5 rekomandime gjithsej. Tre prej raporteve kanë pasqyruar seancat dëgjimore me drejtuesit e KLGJ, KLP dhe KED, ndërsa 4 raportet e tjera kanë trajtuar monitorimin e procedurave dhe dhënien e rekomandimeve për disa emërime në KLP, KED dhe për përzgjedhjen e kandidaturave për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

Nga pikëpamja metodologjike, termi raportim nuk duhet ngatërruar me qëndrimet institucionale që shoqërohen me rekomandime përkatëse. Gjetjet e parregullsive për një procedurë të veçantë të kryer nga organet e drejtësisë, nuk duhet të evidentohen me raporte të mirëfillta, të cilat kanë një konotacion më të përgjithshëm në trajtimin e çështjeve, por me rekomandime zyrtare me anë të shkresave të veçanta. Fakti që këto rekomandime janë adresuar në mënyrë periodike si raporte të mirëfillta, tregon kujdesin e tepruar që është treguar nga ana e Komisionit të Pavarur për të përmbushur detyrimet ligjore për të raportuar çdo muaj pranë Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit.

Lidhur me aksesin dhe monitorimin nga afër të Komisionit të Pavarur në veprimtarinë e institucioneve të drejtësisë, është për tu evidentuar fakti se anëtarë të veçantë të tij kanë marrë pjesë në mënyrë të vazhdueshme në seanca të posaçme ku janë zhvilluar votime, hedhje shorti apo diskutime mbi kritere për përzgjedhjen e kandidaturave për në organet e drejtësisë. Megjithatë, Komisioni i Pavarur ka hasur në vështirësi për të monitoruar dhe qenë prezent në mbledhjet e Komisionit të Emërimeve në Drejtësi në kundërshtim më ligjin. Qëndrimi që mbahet nga Kryetari i KED lidhur me zhvillimin e mbledhjeve me dyer të mbyllura, përfshirë këtu përjashtimin nga seancat edhe të Komisionit të Pavarur është i pajustifikuar ligjërisht dhe pengon në thelb përmbushjen e detyrave të këtij komisionit.

Referuar kompetencave të Komisionit të Pavarur dhe marrëdhënieve që ky institucion ka krijuar me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë, qofshin këto edhe në aspektin e zgjidhjes së rekomandimeve të adresuara, lipset që Komisioni i Pavarur të promovojë mekanizma më të qenësishëm të presionit institucional. Pjesë e kësaj strategjie nevojitet të jenë edhe strukturat e larta të Kuvendit të Shqipërisë, në të cilat raporton Komisioni i Pavarur, me qëllim rritjen e rolit dhe impaktit të tij ndaj forcimit të standardeve të aktivitetit të organeve të drejtësisë.

[39] *Periudha Qershor 2019-Shkurt 2020*

Në kuadër të veprimtarisë monitoruese, raportuese dhe koordinuese të Komisionit të Pavarur nevojitet të qartësohet edhe më shumë fokusi i këtij aktiviteti gjatë punës të organeve të drejtësisë. Në këtë aspekt është konstatuar se midis përmbajtjes së Nenit 288 të ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" që normon objektin e veprimtarisë së Komisionit të Pavarur dhe Vendimit Nr. 74 datë 31.05.2018 të Kuvendit që krijon këtë organ, ka një papajtueshmëri në shtrirjen e kompetencave.

Konkretisht në ligjin për organet e qeverisjes së sistemit të qeverisjes[40] është parashikuar se Komisioni i Pavarur e fokuson aktivitetin e tij vetëm në kuadër të monitorimit të proceseve të përzgjedhjes së kandidatëve dhe të zgjedhjes dhe emërimit të anëtarëve të organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë. Ndërsa në vendimin e mësipërm të Kuvendit të Shqipërisë[41], fokusi i aktivitetit të Komisionit të Pavarur është zgjeruar, duke parashikuar edhe kompetenca të tjera, duke i ngarkuar atij detyrën për një monitorim më të përgjithshëm të zbatimit të Ligjit Nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë". Pavarësisht kësaj mospërputhje, nga monitorimi i akteve dhe raporteve të publikuara nga Komisioni i Pavarur, vihet re se ky organ i është përmbajtur fokusit të përcaktuar në ligjin e mësipërm, duke mos e zgjeruar aktivitetin e tij në mënyrë abuzive.

Bazuar në Vendimin Nr. 74 datë 31.05.2018 të Kuvendit të Shqipërisë[42], Komisioni i Pavarur përfundon veprimtarinë e tij me ngritjen dhe fillimin e funksionimit të plotë të organeve të reja drejtësisë. Në këtë kuadër ka një paqartësi nëse këto organe janë vetëm KLP, KLGJ dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë apo edhe Gjykata e Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë, të cilat duhet të rihapen sipas formulave të reja të përzgjedhjes kushtetuese dhe ligjore. Nga veprimtaria e Komisionit të Pavarur konstatohet se ky organ po konsideron krijimin edhe të gjykatave të mësipërme si kusht për përfundimin e mandatit të tij institucional.

[40] *Neni 288 i Ligjit Nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" dhe Vendimi 74/2018 të Kuvendit të Shqipërisë*
[41] *Pika 2 e Vendimit Nr. 74 datë 31.05.2018 i Kuvendit te Shqiperise*
[42] *Pika 4 e Vendimit Nr. 74 datë 31.05.2018 i Kuvendit te Shqiperise*

Rekomandime:

- ✓ Hartimin e raportit të punës mbi problematikat dhe rezultatet për periudhën Qershor 2019-Shkurt 2020 dhe publikimin e tij për njohje në rubrikën *online*.
- ✓ Plotësimin dhe përditësimin e plotë dhe të vazhdueshëm të rubrikës së dedikuar për Komisionin e Pavarur në faqen zyrtare online të Kuvendit të Shqipërisë, lidhur me të dhënat mbi anëtarët e Komisionit të Pavarur, zhvillimin e mbledhjeve dhe tematikat e tyre, procesverbalet e mbledhjeve, dokumente mbi programin e transparencës ndaj publikut, regjistrin elektronik të kërkesave për të drejtën e informimit, datat e raporteve të skanuara në faqe etj ;
- ✓ Forcimin e kapaciteteve institucionale dhe shfrytëzimin e mekanizmave kuvendorë për të ndjekur dhe ndikuar në pranimin dhe zgjidhjen e çështjeve të adresuara në rekomandimet përkatëse;
- ✓ Miratimin e Kodit Etik dhe rregullave të tjera në marrëdhëniet me publikun;
- ✓ Vijimin e ndjekjes për zbatimin e rekomandimeve që janë pa përgjigje nga organet e drejtësisë;
- ✓ Qartësimin e dallimeve midis shkresave që ngrenë rekomandime të posaçme dhe raportimeve të përgjithshme, me anë të një metodologjie të kuptueshme;
- ✓ Saktësimin e periudhës mandatuese ligjore të përfundimit të veprimtarisë së këtij institucioni.